

(2) Кога сторителот на прекршокот е согласен со постапката за порамнување, инспекторот составува записник и му издава прекршочен платен налог на одговорното лице или од него овластено лице.

(3) Записникот и платниот налог ги потпишуваат инспекторот и сторителот на прекршокот. По приемот на прекршочниот платен налог сторителот е должен да ја плати глобата изречена во прекршочниот платен налог, во рок од осум дена од денот на приемот на прекршочниот платен налог.

(4) Кога како сторител на прекршок се јавува правно лице, записникот и прекршочниот платен налог го потпишува одговорното лице или од него овластено лице.

(5) Сторителот кој ќе ја плати глобата во рокот од ставот (3) на овој член ќе плати само половина од изречената глоба за кое право се поучува во правната поука.

(6) Ако сторителот не ја плати глобата во рокот од ставот (3) на овој член, инспекторот ќе поднесе барање за поведување прекршочна постапка до надлежен орган.

(7) Во постапката за порамнување глобата во прекршочниот платен налог се изрекува во фиксен износ пропишан со закон, а ако глобата е пропишана во распон се изрекува минималниот пропишан износ за прекршокот.

(8) Во постапката која ќе заврши со плаќање на прекршочен платен налог не се плаќаат трошоци на постапката.

(9) Доколку сторителот не се согласи да му биде издаден прекршочен платен налог, истото ќе се забележи во записникот за констатиран прекршок, а инспекторот поднесува барање за поведување на прекршочна постапка пред надлежниот суд.

#### Член 103

Одмерувањето на висината на глобата за правните лица се врши согласно со Законот за прекршоците.

#### Член 104

За прекршоците од членот 101 од овој закон прекршочна постапка води и прекршочни санкции изрекува надлежен суд.

### XIII. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

#### Член 105

Националното координативно тело од членот 15 од овој закон ќе се формира во рок од три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

#### Член 106

Постапките започнати до денот на отпочувањето на примената на овој закон ќе завршат според одредбите од овој закон.

#### Член 107

Законите коишто содржат одредби кои се однесуваат на спречување и заштита од насилство врз жени и семејно насилство ќе се усогласат со овој закон во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

#### Член 108

Подзаконските акти предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

#### Член 109

Со денот на започнувањето на примената на овој закон престанува да важи Законот за превенција, спречување и заштита од семејно насилство („Службен весник на Република Македонија“ број 138/14, 33/15 и 150/15).

#### Член 110

Со денот на започнувањето на примената на овој закон, престанува мандатот на претседателот и членовите на Националното координативно тело за спречување и заштита од семејно насилство.

#### Член 111

Одредбите од членот 20 точка 2) и членот 87 ставови (2) и (3) од овој закон ќе започнат да се применуваат во рок од две години од денот на влегувањето во сила на овој закон.

#### Член 112

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“, а ќе започне да се применува по три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

## L I G J

### I PARANDALIMIT DHE I MBROJTJES NGA DHUNA NDAJ FEMRAVE DHE DHUNËS NË FAMILJE

#### I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

##### Lënda e ligjit

##### Neni 1

Me këtë ligj rregullohet veprimi i institucioneve me kujdesin e vaçantë gjatë marrjes së masave për parandalimin e dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje, veprimi i institucioneve për mbrojtjen e femrave nga dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje, koordinimi i ndërsjellë i institucioneve dhe organizatave, shërbimet për mbrojtjen e viktimave dhe mbledhja e të dhënave për dhunën me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje.

##### Qëllimi i ligjit

##### Neni 2

Qëllimi i ligjit është parandalimi dhe pengimi i dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje, mbrojtja efektive e viktimave nga çdo formë e dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe viktimave të dhunës në familje duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe marrëveshjet ndërkombëtare të

ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare). Qëllimi i ligjit bazohet në parimin e barazisë dhe eliminimit të stereotipeve për rolet gjinore.

### Përkufizime

#### Neni 3

Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë këtë domethënie:

1) "**Dhuna ndaj femrave**" është shkelje e të drejtave të njeriut, diskriminim ndaj femrave dhe nënkupton të gjitha veprimet e dhunës me bazë gjinore që çojnë ose ka të ngjarë të çojnë në dëmtime fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike të femrave, përfshirë edhe kërcënime të drejtpërdrejta ose indirekte dhe frikësime për veprime të tilla, shantazhim, kufizime arbitrare dhe / ose heqje lirie, qofshin këto që ndodhin në jetën publike ose private.

2) "**Dhuna me bazë gjinore ndaj femrave**" është dhuna e drejtuar kundër femrës, sepse është femër ose që e prek në mënyrë joproporcionale. Dhuna me bazë gjinore ndaj femrave i përfshin shkaqet dhe rezultatit e marrëdhënies së pabarabartë të forcës ndërmjet femrave dhe meshkujve si rezultat i një problemi social e jo individual. Dhuna me bazë gjinore ndaj femrave ka të bëjë edhe me dhunën ndaj femrave të përcaktuar në pikën 1 dhe pikën 3 të këtij neni.

3) "**Dhunë në familje**" është keqtrajtimi, ofendimi, rrezikimi i sigurisë, dëmtimi fizik, dhuna seksuale ose dhuna tjetër psikologjike, fizike ose ekonomike me të cilën shkaktohet ndjenjë e pasigurisë, kërcënimit ose frikës, përfshirë edhe kërcënime për veprime të tilla, ndaj bashkëshortit, prindërve ose fëmijëve ose personave të tjerë që jetojnë në një bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose në një ekonomi familjare të përbashkët, si dhe ndaj një bashkëshorti aktual ose të mëparshëm ose partnerit jashtëmartesor ose personave që kanë një fëmijë të përbashkët ose janë në një lidhje të ngushtë personale, pavarësisht nëse kryerësi i veprës e ndan ose e ka ndarë të njëjtin vendbanim me viktimën apo jo.

4) "**Marrëdhënie të afërta personale**" janë marrëdhëniet personale midis personave që janë ose kanë qenë në marrëdhënie partneriteti, pavarësisht nëse kryerësi e ndan ose ka ndarë të njëjtin vendbanim me viktimën ose jo.

5) "**Dhuna nga partneri intim**" është sjellje e bashkëshortit apo partneri aktual ose të mëparshëm që shkakton dhunë fizike, seksuale, psikike ose ekonomike.

6) "**Seksi**" nënkupton karakteristikat fizike të individit (sistemi riprodhues, kromozomet, hormonet) sipas të cilave përcaktohet gjinia e cila individëve u përcaktohet në lindje, bazuar në kombinimin e karakteristikave trupore dhe organeve të brendshme riprodhuese.

7) "**Gjinia**" nënkupton rolet e ndërtuara shoqërore, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për femrat dhe meshkujt.

8) "**Person transjinator**" është personi, gjinia e të cilit nuk identifikohet me seksin e përcaktuar në lindje.

9) "**Viktimë**" është çdo person fizik i cili është i ekspozuar ndaj dhunës i theksuar në pikat 1, 2, 3 dhe 5 të këtij neni, në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

10) "**Kryerës**" është çdo person fizik dhe juridik që ka kryer ose nuk ka ndërmarrë ndonjë nga veprimet e përmendura në pikat 1, 2, 3 dhe 5 të këtij neni.

11) "**Femra**" i përfshin edhe vajzat e moshës nën 18 vjeç.

12) "**Moskthimi**" është një parim mbi bazën e të cilit shteti obligohet femrat dhe fëmijët azilkërkues, persona me status të refugjatit ose persona nën mbrojtje subsidiare të mos i dëbojë ose t'i kthejë ato në asnjë mënyrë në kufijtë e shtetit në të cilin direkt ekziston rrezik për jetën dhe trupin, nga dhuna ndaj femrave ose dhuna në familje, ose liria e tyre do të rrezikohej për shkak të racës, fesë, kombësisë, përkatësisë në një grup të caktuar shoqëror ose besimit politik ose kur ato do t'i nënshtroheshin torturave, trajtimeve çnjerëzore ose degraduese ose dënimit.

13) "**Fëmijë**" është çdo person deri në moshën 18 vjeçare.

14) "**Dhuna fizike**" është çdo veprim i aplikimit të forcës fizike ose veprim me të cilin prishet shëndeti dhe integritetin fizik dhe psikik i viktimës.

15) "**Dhunë psikike**" është çdo sjellje që përdor detyrimin, frikësimin ose kërcënimin, që shkakton ndjenjë e frikës, rrezikimit, ankthit ose cenimit të dinjitetit dhe integritetit psikik të viktimës.

16) "**Ndjekje**" është çdo sjellje e qëllimshme e kërcënimit të përsëritur drejtuar një personi tjetër që shkakton që personi të frikësohet për sigurinë e tij.

17) "**Dhunë ekonomike**" është çdo veprim i kufizimit ose parandalimit të realizimit dhe / ose disponimit me të ardhura personale dhe mjeteve financiare, për mirëmbajtjen e amvisërisë së përbashkët dhe për kujdesin ndaj fëmijës, me çka shkaktohet varësi ekonomike e viktimës.

18) "**Dhuna seksuale dhe përdhunimi**" është çdo veprim i natyrës seksuale, me çdo pjesë të trupit ose objekt, në trupin e një personi tjetër pa pëlqimin e tij / saj. Dhuna seksuale ekziston gjithashtu kur një person tjetër nxitet ose detyrohet të përfshihet me veprime të natyrës seksuale me një person të tretë pa pëlqimin e tij. Pëlqimi duhet të shprehet vullnetarisht si rezultat i vullnetit të lirë të personit, i vlerësuar në kontekstin e rrethanave.

19) "**Shqetësim seksual**" është çdo sjellje verbale, joverbale ose fizike e natyrës seksuale që ka për qëllim ose pasojë të cenimit të dinjitetit të personit, veçanërisht kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, nënçmues ose ofendues.

20) "**Ngacmimi seksual nëpërmjet internetit**" është çdo veprim verbal, joverbal ose çdo veprim tjetër i natyrës seksuale, që ka për qëllim ose pasojë, cenimin e dinjitetit ose krijimin e një mjedisi, qasjeje ose praktike kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese komunikimi.

21) "**Martesa e detyruar**" nënkupton detyrimin, joshjen, mashtrimin, kërcënimin ose detyrimin ndryshe të një të rrituri ose fëmije të martohet ose në bashkësi jashtëmartesore.

22) "**Gjymtimi gjenital i femrës**" është prerja, infibulimi ose ndonjë gjymtim tjetër në tërësi ose pjesërisht i buzëve të mëdha (labia majora), buzëve të vogla (labia minora) ose klitorit të femrës.

23) **"Abort i detyruar dhe sterilizim i detyruar"** është ndërprerja e shtatzënisë së një femre pa njoftim paraprak dhe pajtim me shkrim, si dhe kryerja e operacionit të një femre pa njoftim paraprak dhe miratim me shkrim përkatësisht kuptimin e procedurës qëllimi ose pasoja e së cilës është të përfundojë aftësinë e saj për riprodhim natyral.

24) **"Trafikimi i femrave"** është një veprim me anë të të cilit me forcë, kërcënim serioz viktima mashtrohet ose forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të pozitës së saj ose gjendjes së shtatzënisë, pafuqisë ose paaftësisë fizike ose mendore të një tjetri, ose duke dhënë ose marrë para ose përfitime të tjera me qëllim të marrjes së pajtimit të personit i cili ka kontroll mbi një person tjetër ose përndryshe rekruton, transporton, transferon, blen, shet, strehon ose pranon persona për shkak të shfrytëzimit nëpërmjet prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, pornografi, punë e detyruar ose shërbim, skllavëri, martesat e detyruara, shtatzënitë e detyruara, birësimi i paligjshëm ose marrëdhënie të ngjashme, lypja ose shfrytëzimi për aktivitete të ndaluara me ligj ose transplantimi i palejueshëm i pjesëve të trupit të njeriut.

25) **"Kontroll i detyruar ndaj femrave"** është keqpërdorimi i fuqisë, përdorimi i kërcënimeve, forcë ose forma tjera të detyrimit, mashtrimit ose keqpërfaqësimit në mënyrë që të kontrollohet sjellja dhe jeta e femrave.

### Kujdesi i detyrueshëm

#### Neni 4

(1) Organet e pushtetit shtetëror, personat juridikë që kryejnë autorizime publike të përcaktuara me ligj, funksionarët, zyrtarët dhe personat e tjerë të autorizuar që kryejnë punë në emër të shtetit, janë të detyruar të përmbahen nga pjesëmarrja në akte dhune dhe të marrin të gjitha masat dhe aktivitetet për të parandaluar çdo efekt të dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje.

(2) Subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të detyruar të marrin të gjitha masat e duhura legjislative, administrative, gjyqësore dhe masa të tjera për të parandaluar, mbrojtur, hetuar, ndëshkuar dhe siguruar kompensim të drejtë të viktimave ose të kthehen në pozicionin origjinal për veprime dhune të kryera nga persona fizikë ose juridikë.

(3) Personat zyrtarë në institucionet që kryejnë veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale, punëve të brendshme, shëndetësisë, mbrojtjen e fëmijëve dhe arsimin, si dhe gjykatat kompetente dhe prokuroritë në procedurat për dhunën në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje janë të detyruar të veprojnë urgjentisht, me kujdesin e veçantë ndaj interesave dhe nevojave të viktimës.

## II. PARIMET THEMELORE

### Mosdiskriminimi

#### Neni 5

(1) Dhuna me bazë gjinore ndaj femrave është diskriminim ndaj femrave që i kufizon ato të gëzojnë të drejtat dhe liritë mbi një bazë të barabartë me meshkujt.

(2) Masat, aktivitetet dhe shërbimet e këtij ligji do të ndërmerren për të zbatuar principin e barazisë, për të eliminuar stereotipet në lidhje me rolet gjinore, parandalimin dhe mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit ndaj femrave viktima të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje.

(3) Masat, aktivitetet dhe shërbimet për parandalimin dhe mbrojtjen e femrave nga dhuna me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje do të zbatohen pa diskriminim në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës kombëtare ose etnisë, seksit, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë në grup të marginalizuar, gjuha, kombësia, origjina shoqërore, arsimit, feja ose besimi, besimi politik, besimi tjetër, paaftësia, mosha, statusi familjar ose martesor, statusi pronësor, gjendja shëndetësore, statusi personal dhe statusi shoqëror ose në çfarëdoq bazë tjetër.

(4) Masat, aktivitetet dhe shërbimet e këtij ligji, të cilat ndërmerren për parandalimin dhe mbrojtjen e femrave nga dhuna në bazë gjinore dhe dhuna në familje, nuk do të konsiderohen diskriminim.

### Ndalimi i viktimizimit

#### Neni 6

Ndalohet çdo veprim i ndërmarrë me qëllim që të ndëshkohet ose pa dashje ose të vihet në pozicion më pak të favorshëm një person i cili ka ndërmarrë veprime për të mbrojtur nga dhuna në bazë gjinore dhe dhuna në familje, përkatësisht nëse personi ka raportuar dhunë, ka filluar një procedurë për mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore dhe dhuna në familje dhunë, ka dëshmuar gjatë procedurës ose në mënyrë tjetër ka marrë pjesë në procedurën për mbrojtjen nga dhuna në bazë gjinore dhe dhunës në familje.

### Femrat e cenuara

#### Neni 7

Subjektet sipas neneve 11 dhe 24 të këtij ligji, janë të detyruara gjatë ndërmarrjes së masave dhe aktiviteteve t'i marrin në konsideratë pasojat që dhuna në bazë gjinore e ka mbi kategoritë e prekshme të femrave, veçanërisht femrat shtatzëna, femrat me fëmijë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara, nënat e vetme, femrat me aftësi të kufizuara, femrat nga ambientet rurale, femrat të cilat përdorin droga, punëtore seksi, migrante, refugjate, azilkërkuese, femra pa shtetësi, lezbike, biseksuale dhe transgjimore, femra që jetojnë me HIV, femra të pastreha, femra viktima të trafikimit me njerëz, femra të moshuara, femra të pasigurta materialisht dhe të tjera.

### Përshtatja adekuate

#### Neni 8

Masat, aktivitetet dhe shërbimet për viktimat e dhunës në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje duhet të përshtaten me nevojat specifike të femrave me aftësi të kufizuara.

### Parimi i politikave të përgjegjshme gjinore

#### Neni 9

(1) Masat, aktivitetet dhe shërbimet për preventivë dhe mbrojtje të femrave nga dhuna e bazuar gjinore dhe dhuna në familje, duhet të jenë përgjegjshme gjinore dhe t'i njohin karakteristikat dhe dallimet të cilët dalin nga rolet gjinore të femrave dhe burrave, që të mundet rezultatet e masave, aktiviteteve dhe shërbimeve të kontribuojnë për barazi gjinore.

(2) Politikat përgjegjëse gjinore e përfshijnë perspektivën gjinore si kriter i cili është i integruar në të gjitha fazat nga procesi i krijimit të politikave, vlerësimi i gjendjeve, zbatimi dhe vlerësimi i politikave të cilat rrjedhin nga ky ligj.

#### **Parimi i përforsimit të femrave të cilët pësojnë dhunë**

##### **Neni 10**

(1) Masat, aktivitetet dhe shërbimet për preventivë dhe mbrojtje të femrave nga dhuna e bazuar gjinore dhe nga dhuna në familje, si sigurohen në mënyrë që mundëson përforsimin e potencialit dhe kapaciteteve të viktimave për organizim të pavarur të jetës dhe vetë-ndihmë në të ardhmen.

(2) Viktima ka të drejtë të marrë pjesë në vlerësimin e gjendjes dhe nevojave, të njoftohet për masat, aktivitetet dhe shërbimet për mbrojtje dhe të marrë pjesë në zgjedhjen e shërbimeve dhe masave për ndihmë të saj, përkrahje dhe mbrojtje.

(3) Pa pajtim të viktimës, përkatësisht përfaqësuesit të saj ligjor, nuk mund të ndërmerren masat, aktivitetet dhe shërbimet për mbrojtje, përveç kur ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për jetën dhe trupin e saj.

### **III. INSTITUCIONET KOMPETENTE DHE POLITIKAT E INTEGRUARA**

#### **Kompetenca për zbatimin e ligjit**

##### **Neni 11**

(1) Kompetente për zbatimin e këtij ligji janë të gjitha organet e administratës shtetërore, gjykatat, prokuroria publike, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe personat juridikë të cilët kryejnë autorizime publike të përcaktuara me ligji.

(2) Subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni, janë të detyruar që të sigurojnë punët nga kompetenca e vet ta kryejnë persona profesionalë, të trajnuar për zbatimin e punëve të përcaktuara me këtë ligj.

#### **Bashkëpunimi institucional dhe shumësektorial**

##### **Neni 12**

(1) Subjektet sipas nenit 11 të këtij ligji janë të detyruar ndërmjet veti të bashkëpunojnë për realizimin e qëllimeve të këtij ligji me përgatitjen e protokollit për bashkëpunim të ndërsjellë.

(2) Njësitë e vetëqeverisjes lokale me institucionet dhe shoqatat, përgatisin protokoll për bashkëpunim ndërmjet veti për ndërmarrjen e masave për preventivë, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje në bashkësinë lokale.

#### **Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut**

##### **Neni 13**

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, miraton strategji nacionale për preventivë dhe mbrojtje nga dhuna e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhëna në familje (në tekstin e mëtejshëm: Strategjia).

(2) Strategjia miratohet për periudhën prej tetë viteve, kurse zbatohet nëpërmjet dy planeve nacionale të veprimit në kohëzgjatje prej nga katër vjet dhe planeve operative vjetore në nivel të institucioneve kompetente.

(3) Kuvendi e ndjek zbatimin e strategjisë dhe të shpenzimeve të mjeteve nga buxheti për planet vjetore operative nëpërmjet raportit vjetor të trupit nacional bashkërendues sipas nenit 15 të këtij ligji.

#### **Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut**

##### **Neni 14**

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria, në kuadër të kompetencave të veta ndërmerr masa dhe aktivitete për preventivë dhe mbrojtje të dhunës së bazuar gjinore, ndaj femrave dhe dhunës në familje nëpërmjet përfshirjes së principit të barazisë dhe eliminimit të stereotipave për role gjinore në propozimet e ligjeve dhe rregullave të tjera; organizimin dhe financimin e kampanjave nacionale për ngritjen e vetëdijes për të gjitha format e dhunës së bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje e të tjera.

#### **Trupi bashkërendues nacional për implementimin e Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës në familje**

##### **Neni 15**

(1) Qeveria formon trup bashkërendues nacional për implementimin e Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës në familje (në tekstin e mëtejshëm: Trupi nacional bashkërendues), me mandat prej pesë viteve.

(2) Trupi nacional bashkërendues sipas paragrafit (1) të këtij neni, përbëhet prej një përfaqësuesi i Sekretariatit Gjeneral të Qeverisë, tre nëpunës udhëheqës nga Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, anëtar dhe zëvendësanëtar i Ministrisë së Shëndetësisë, anëtar dhe zëvendësanëtar nga Ministria e Drejtësisë, anëtar dhe zëvendësanëtar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, anëtar dhe zëvendësanëtar nga Ministria e Punëve të Brendshme, gjykatës dhe prokurorë publikë, përfaqësuesi i njësisë të vetëqeverisjes lokale dhe përfaqësuesi i shoqatës, sindikatës dhe shoqatave të punëdhënësve, nga një përfaqësues nga Komisioni për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve dhe nga Klubi i deputeteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut e propozon përfaqësuesi i gjykatësve si anëtar i trupit nacional bashkërendues.

(4) Këshilli i prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut e propozon përfaqësuesin e prokurorëve publikë si anëtar i trupit nacional bashkërendues.

(5) Bashkësia e njësisë të vetëqeverisjes lokale e propozon përfaqësuesin e njësisë të vetëqeverisjes lokale si anëtar i trupit nacional bashkërendues.

(6) Qeveria publikon thirrje publike për zgjedhje të tre anëtarëve të trupit bashkërendues nacional nga radhët e shoqatave, të cilët duhet të kenë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e dhunës ndaj femrave dhe dhënës familjare.

(7) Mënyra e punës së trupit bashkërendues nacional rregullohet me rregulloren e punës.

(8) Me Trupin bashkërendues nacional kryeson ministri i Punës dhe politikës sociale.

(9) Punët administrative-profesionale për nevojat e Trupit bashkërendues nacional i kryen Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale.

**Fushëveprimi i Trupit nacional bashkërendues****Neni 16**

Trupi bashkërendues nacional i kryen këto punë:

- 1) e përgatit dhe ndjek realizimin e Strategjisë;
- 2) i përgatit dhe ndjek planet nacionale të veprimit;
- 3) e koordinon punën e institucioneve në pjesën e preventivit dhe mbrojtjes së dhëna e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje;
- 4) e ndjek zbatimin e Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj femrave dhe dhunës në familje dhe politikave nacionale nga sfera e dhunës së bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje;
- 5) e ndjek dhe analizon gjendjen me dhunën e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje;
- 6) i ndjek mjetet e planifikuara dhe të shpenzuara financiare të ndara në organet e neneve 11 dhe 24 të këtij ligji;
- 7) jep mendim dhe rekomandime për përmirësimin e politikave dhe miratimin e masave dhe aktiviteteve nga sfera e dhunës së bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje;
- 8) e ndjek zbatimin e rekomandimeve të trupave ndërkombëtar dhe regjional për dhunë të bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje dhe propozon aktivitete dhe masa për zbatimin e tyre;
- 9) e promovon principin e barazisë dhe eliminimin e stereotipeve për role gjinore;
- 10) jep mendim për metodologjinë për grumbullimin e integruar të të dhënave për dhunën e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje nga të gjitha institucionet relevante dhe organizatat kompetente ta zbatoj këtë ligj;
- 11) jep mendim për programet për edukim fillestar dhe të vazhdueshëm të personave profesional që sigurojnë shërbime të specializuara të femrave viktime të dhunës së bazuar gjinore dhe viktimat e dhunës në familje me kërkesë të Ministrisë së Punës dhe e Politikës Sociale;
- 12) e koordinon dhe ndjek grumbullimin e të dhënave për dhunë të bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje sipas indikatorëve të përcaktuar paraprakisht dhe
- 13) dorëzon raport vjetor për aktivitetet e ndërmarra dhe përparimin e arritur për gjendjen me dhunën e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje në pajtim me Strategjinë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për shqyrtim, më së voni deri në fund të qershorit për vitin paraprak.

**Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale****Neni 17**

(1) Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale i kryen këto punë:

- 1) krijon politika për preventivë dhe mbrojtje të femrave nga dhuna e bazuar gjinore dhe viktimat e dhunës në familje;
- 2) përgatit program për edukim fillestar dhe i vazhdueshëm i personave profesional që sigurojnë shërbime të specializuara të femrave viktime të dhunës së bazuar gjinore dhe viktimat e dhunës familjare, nëpërmjet Entit të Veprimtarisë Sociale;
- 3) zbaton edukim fillestar dhe të vazhdueshëm për personat profesionalë nga qendrat për punë sociale për kryerjen e punëve nga kompetenca e vet për dhunë të bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje nëpërmjet Entit të Veprimtarisë Sociale;
- 4) jep pajtim për programin e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm për dhunë të bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje që i zbatojnë subjektet sipas neneve 18, 19 dhe 20 të këtij ligji;

5) jep mendim për programin e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm për dhunë të bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje që i zbaton subjekti sipas nenit 23 të këtij ligji;

6) mban regjistër të personave të trajnuar për zbatimin e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm për dhunë të bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje;

7) siguron mjete financiare për përkrahjen e shërbimeve për preventivë dhe mbrojtje nga dhuna e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje në sferën e mbrojtjes sociale në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;

8) mbledh të dhëna për numrin e femrave viktime të dhunës së bazuar gjinore dhe viktimat e dhunës në familje në sistemin e mbrojtjes sociale të ndara sipas: gjinisë, moshës, përkatësisë së bashkësisë, vendbanimit, raportit të viktimës dhe kryerësit, llojit dhe numrit të shërbimeve të siguruara për viktimat dhe kryerësit dhe të dhënat tjera të përcaktuara me ligj nga institucionet në sistemin e mbrojtjes sociale dhe nga institucionet tjera kompetente ta zbatojnë këtë ligj;

9) e ndjek dhe analizon gjendjen me dhunën e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje, dhe për të njëjtat e njofton Trupin nacional bashkërendues së paku një herë në vit;

10) bashkëpunon me shoqatat, fondacionet dhe organizatat tjera në promovim, preventivë dhe mbrojtje nga dhuna e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhuna familjare dhe

11) kryen punë tjera nga sfera e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna e bazuar gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje në pajtim me ligjin.

(2) Mënyrën e dhënies së pajtimit të programit të edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm sipas paragrafit (1) pika 4) e këtij neni, e përcakton ministri i Punës dhe I Politikës Sociale.

(3) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së regjistrimit sipas paragrafit (1) pika 6) të këtij neni, e përcakton ministri i Punës dhe I Politikës Sociale.

**Ministria e Punëve të Brendshme****Neni 18**

Ministria e Punëve të Brendshme i kryen punët si në vijim:

1) krijon politika për parandalim dhe mbrojtje të femrave nga dhuna në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje;

2) përgatit program për zbatimin e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm për nëpunësit policorë të cilët punojnë në parandalimin dhe mbrojtjen e femrave viktime të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje dhe e dorëzon në Ministrinë e Punës dhe e Politikës Sociale për marrjen e pëlqimit;

3) zbaton edukim fillestar dhe të vazhdueshëm për nëpunësit policorë për kryerjen e punëve nga kompetenca e tij për dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje;

4) ndërmer veprime për shkak të ndjekjes së kryerësve të dhunës në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje, në pajtim me ligjin;

5) siguron mjete financiare për mbështetjen e aktiviteteve për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;

6) e ndjek dhe analizon gjendjen me dhunën në bazë gjinore ndaj femrave dhe viktimat e dhunës në familje, dhe për të njëjtën e njofton Trupin Nacional Bashkërendues së paku njëherë në vit;

7) grumbullon të dhëna për numrin e rasteve të paraqitura me dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe viktimat e dhunës në familje të ndarë sipas: gjinisë, moshës, bashkësisë etnike, pengesës, vendbanimit, raportit të viktimës dhe kryerësit, kualifikimit të veprës penale dhe të dhëna tjera të përcaktuara me ligj;

8) bashkëpunon me shoqatat, fondacionet dhe organizatat tjera në promovim, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje;

9) ndërmerri masa urgjente për mbrojtje të femrave nga dhuna në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje dhe

10) kryen punë të tjera nga kompetenca e vet me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje në pajtim me ligjin.

### Ministria e Shëndetësisë

#### Neni 19

Ministria e Shëndetësisë i kryen punët siç vijon:

1) krijon politika për parandalim dhe mbrojtje të femrave nga dhuna në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje;

2) kujdeset për sigurimin e shërbimeve shëndetësore në rrejtin e institucioneve shëndetësore për viktimat dhe kryerësit e dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje;

3) planifikon dhe jep rekomandime të institucionet shëndetësore për formimin e qendrave për dërgimin e viktimave të dhunës seksuale;

4) siguron mjete financiare për mbështetjen e aktiviteteve dhe vendosjen dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje në sferën e mbrojtjes shëndetësore në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;

5) e informon publikun dhe punëtorët shëndetësorë, për disponueshmërinë e shërbimeve ekzistuese për trajtimin dhe mbështetjen e femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore, dhe viktimave të dhunës në familje;

6) përgatit program për zbatimin e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm për punëtorët shëndetësorë të cilët punojnë në mbrojtjen e femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje dhe e dorëzon në Ministrinë e Punës dhe e Politikës Sociale për marrjen e pëlqimit;

7) zhvillon edukim fillestar dhe të vazhdueshëm për punëtorët shëndetësorë për zbulimin, kujdesin dhe ndihmën e hershme për femrat viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimat të dhunës në familje;

8) mbledh të dhëna për situatën me femrat viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje që kanë kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje nëpërmjet sistemit të mbrojtjes shëndetësore të ndarë sipas: gjinisë, moshës, bashkësisë etnike, pengesës, vendbanimit, raportit të viktimës dhe kryerësit, llojit dhe numrit të shërbimeve të siguruar për viktimat dhe të dhëna tjera në pajtim me ligjin e Evidencës në Sferën e Shëndetësisë, si dhe për kryerësit;

9) e ndjek dhe analizon gjendjen me dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje, në bazë të të dhënave nga Sistemi nacional për evidenca elektronike në shëndetësi që mbahet në pajtim me ligjin për evidenca në sferën e shëndetësisë dhe për të njëjtën e njofton Trupin nacional bashkërendues së paku njëherë në vit;

10) bashkëpunon me shoqatat, fondacionet dhe organizatat tjera në promovim, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje dhe

11) kryen punë tjera nga kompetenca e vet me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje, në pajtim me ligjin.

### Ministria e Drejtësisë

#### Neni 20

Ministria e Drejtësisë i kryen punët si në vijim:

1) siguron ndihmë juridike falas në pajtim me ligjin;

2) siguron mjete financiare për kompensim për femrat viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje në pajtim me ligjin;

3) siguron mjete financiare për mbështetjen e aktiviteteve për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;

4) përgatit program për zbatimin e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm për personat zyrtarë të autorizuar të Ministrisë së Drejtësisë, shoqatat e autorizuar dhe klinika juridike dhe avokatët për mbrojtjen e femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje dhe e dorëzon në Ministrinë e Punës dhe e Politikës Sociale për marrjen e pëlqimit;

5) zbaton edukim fillestar dhe të vazhdueshëm për personat e autorizuar zyrtarë dhënë të ndihmës juridike falas, për mbështetje dhe ndihmë të femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës familjare nëpërmjet trajnuesve të evidentuar në regjistrin e Ministrisë së Punës dhe e Politikës Sociale;

6) grumbullon të dhëna për numrin e kërkesave për ndihmë juridike falas të femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje të ndara sipas: gjinisë, moshës, bashkësisë etnike, pengesës, vendbanimit, raportit të viktimës dhe kryerësit, llojit dhe numrit të shërbimeve të siguruar për viktimat dhe të dhëna të përcaktuara me ligj;

7) e ndjek dhe analizon gjendjen me dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje, dhe për të njëjtën e njofton Trupin Nacional Bashkërendues së paku njëherë në vit;

8) bashkëpunon me shoqatat, fondacionet dhe organizatat tjera në promovim, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje dhe

9) kryen punë të tjera nga kompetenca e vet me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së femrave - viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje, në pajtim me ligjin.

### Njësitë e vetëqeverisjes lokale

#### Neni 21

Njësitë e vetëqeverisjes lokale i kryejnë punët si në vijim:

1) krijojnë politika dhe programe lokale për mbrojtje të femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje;

2) themelojnë qendra për kujdesin e viktimave; këshillimore për viktimat; këshillimore për kryerës dhe shërbime tjera për parandalim nga dhuna në bazë gjinore dhe mbrojtje të femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje në pajtim me ligjin e Mbrojtjes Sociale;

3) siguron mjete financiare për funksionim të shërbimeve për parandalim dhe mbrojtje të femrave viktimat të dhunës në bazë gjinore ndaj femrave dhe viktimave të dhunës në familje në nivel lokal në pajtim me nenin 27 të këtij ligji;

4) zbatojnë edukim fillestar dhe të vazhdueshëm për të punësuarit për kryerjen e punëve nga kompetenca e vet për dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje nëpërmjet trajnuesve të evidentuar në regjistrin e Ministrisë së Punës dhe e Politikës Sociale;

5) vendos bashkëpunim të ndërsjellë dhe të koordinuar në nivel lokal ndërmjet qendrave për punë sociale, stacione policore, institucione shëndetësore, institucione parashkollore, arsimore;

6) bashkëpunojnë me shoqatat, fondacionet dhe organizatat tjera në promovim, parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në bazë gjinore të femrave dhe dhuna në familje;

7) Në kuadër të këshillave komunalë për mbrojtje sociale shqyrtohen gjendjet me dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje dhe

8) kryejnë punë tjera nga kompetenca e vet me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje në pajtim me ligjin.

#### **Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale**

Neni 22

Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale i kryen punët si në vijim:

1) në kuadër të kompetencave të veta kujdeset për sigurimin e mbrojtjes së interesave, respektimit të të drejtave të tyre njeriut dhe dinjitetit të femrave viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje;

2) zbaton edukim fillestar dhe të vazhdueshëm për të punësuarit për kryerjen e punëve nga kompetenca e vet për dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje nëpërmjet trajnuesve të evidentuar në regjistrin e Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale;

3) në mënyrë periodike zbaton hulumtime dhe analizë për paraqitjen e dhunës në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje, në programet e dhënësve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale;

4) ndërmerr masa në pajtim me ligjin e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për sanksionimin e dhënësve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale të cilat i prezantojnë femrat në mënyrë të degraduar dhe nuk i respektojnë të drejtat e njeriut të femrave viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje;

5) bashkëpunon me shoqatat, fondacionet dhe organizatat tjera në promovim dhe parandalim nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje dhe

6) kryen punë tjera nga kompetenca e vet me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së femrave viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe dhunës në familje në pajtim me ligjin.

#### **Akademia e Gjykatësve dhe e Prokurorë Publikë**

Neni 23

Akademia e Gjykatësve dhe e Prokurorë Publikë i kryen punët si në vijim:

1) përgatit program për zbatimin e edukimit fillestar dhe të vazhdueshëm për kandidatë, gjykatës dhe prokurorë publikë për mbrojtjen e femrave viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje dhe e dorëzon në Ministrinë e Punës dhe të Politikës Sociale për mendim;

2) zbaton edukim fillestar dhe të vazhdueshëm për kandidatë, gjykatës dhe prokurorë publikë për dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje nëpërmjet trajnuesve të evidentuar në regjistrin e Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale;

3) zbaton hulumtime dhe analizë në sferën e dhunës në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje;

4) bashkëpunon me institucione, shoqata, fondacione dhe organizata tjera në promovim dhe parandalim nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje dhe

5) kryen punë të tjera nga kompetenca e vet me qëllim të parandalimit dhe mbrojtjes së femrave viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje, në pajtim me ligjin.

#### **Shoqatat**

Neni 24

Shoqatat i kryejnë punët si në vijim:

1) sigurojnë trajnim fillestar dhe të vazhdueshëm për personat të cilët zbatojnë aktivitete për parandalim dhe mbrojtje të femrave viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje nëpërmjet trajnuesve të evidentuar në regjistrin e Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale;

2) japin shërbime të specializuara për mbrojtje të femrave viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje,

3) zbatojnë hulumtime dhe analizë për gjendjen me dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje;

4) grumbullojnë të dhëna për numrin e femrave viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje për të cilat kanë siguruar ndihmë dhe mbështetje, të ndara sipas; gjinisë, moshës, bashkësisë etnike, pengesës, vendbanimit, raportit të viktimës dhe kryerësit, llojit dhe numrit të shërbimeve të siguruar për viktimat dhe kryerësit dhe të dhëna të përcaktuara me ligj dhe

5) bashkëpunojnë me institucionet tjera me qëllim të sigurimit të mbrojtjes efikase dhe në kohë të femrave viktimave të dhunës në bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje.

#### **Sindikatat**

Neni 25

Sindikatat zbatojnë hulumtime dhe analiza për gjendjen me dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje, paraqesin raste të dhunës në bazë gjinore ndaj femrave, bashkëpunojnë me shoqatat, fondacionet dhe organizatat tjera në promovim dhe parandalim nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje.

#### **Persona juridikë**

Neni 26

Personat juridikë të cilët kryejnë autorizime publike ndërmarrin masa dhe veprime për promovim të vlerave shoqërore dhe kulturore të sjelljes të cilat bazohen mbi barazimin e femrave dhe burrave dhe eliminimin e stereotipeve për role gjinore dhe parandalim të dhunës në bazë gjinore ndaj femrave në vendin e punës në pajtim me ligjin.

#### **Buxheti për zbatimin e ligjit**

Neni 27

Organet e pushtetit shtetëror, organet e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe personat juridikë të cilët kryejnë autorizime publike të përcaktuara me ligj, janë të detyruar në kuadër të buxheteve të tij resore të veçojnë mjete për zbatimin e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj.

### **IV. GRUMBULLIMI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE**

#### **Grumbullimi i të dhënave**

Neni 28

(1) Subjektet sipas nenit 11 dhe 24 të këtij ligji, grumbullojnë të dhëna statistikore dhe administrative për gjendjen me dhunë në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje, në bazë të gjinisë, moshës, përkatësisë

etnike, vendbanimit dhe të dhëna tjera të përcaktuara me këtë ose ligj tjetër, në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbrojtje të të dhënave.

(2) Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale në bazë ditore duke e shfrytëzuar platformën nacionale për ndërveprueshmëri – Magjistralja Informativ e Maqedonisë (në tekstin e mëtuftjeshëm: MIM), i merr të dhënat nga subjektet e caktuara sipas paragrafit 91) të këtij neni të cilët janë shfrytëzues të MIM, në pajtim me rregullat nga sfera e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike.

(3) Subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni të cilët janë shfrytëzues të MIM dhe nuk kanë mundësi për shkëmbim të drejtpërdrejtë të të dhënave nëpërmjet MIM, janë të detyrueshëm të zhvillojnë ueb servise në platformë adekuate e cila i plotëson kushtet e caktuara me rregullat nga sfera e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike, në të cilat do të përmbahen të dhëna e kërkuara nga Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale.

(4) Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, duke i shfrytëzuar të dhënat e grumbulluara paraprakisht nga subjektet sipas paragrafit (1) të këtij neni, kryen analizë dhe përpunim statistikorë të të njëjtave në sistemin e vet për të drejta dhe shërbime sociale. Analizat dhe raportet në të cilat nuk ka të dhëna të cilat janë mbrojtur me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale i publikon në nivel vjetor në formë dhe përmbajtje që e përcakton ministri i Punës dhe I Politikës Sociale.

(5) Të dhënat sipas paragrafit (1) të këtij neni të cilët nuk përmbajnë të dhëna personale, institucionet kompetente janë të detyruara në formë të përpunuar publikisht t'i publikojnë në internet faqet e veta, si dhe në Katalogun Qendrorë të të dhënave nga sektori publik në pajtim me ligjin për shfrytëzimin e të dhënave nga sektori publik.

(6) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e grumbullimit të integruar të të dhënave sipas paragrafit (1) të këtij neni, futjen e të dhënave në sistemin për të drejta dhe shërbime sociale sipas paragrafit (4) të këtij nenidhe përmbajtja e të dhënave sipas paragrafit (5) të këtij neni, i përcakton ministri i Punës dhe I Politikës Sociale në pajtim me ministrin e Punëve të Brendshme, ministrin e Shëndetësisë dhe ministrin e Drejtësisë.

## Gjykatat

### Neni 29

(1) Gjykatat vendosin dhe mbajnë evidencë të veçantë për numrin e rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe viktimave të dhunës në familje në bazë të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, pengesave, vendbanimit dhe baza të tjera, si dhe të dhëna relevante për ndjekjen e situatës me dhunën në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunën në familje, në pajtim me ligjin.

Përmbajtjen dhe mënyrën e grumbullimit të të dhënave të paragrafit (1) të këtij neni, i përcakton ministri i Drejtësisë.

## Prokuroria publike

### Neni 30

(1) Prokuroritë publike vendosin dhe mbajnë evidencë të veçantë për lëndë të dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe viktimave të dhunës në familje në bazë të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, pengesave, vendbanimit dhe baza të tjera, si dhe të dhëna relevante për ndjekjen e situatës me dhunën në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunën në familje, në pajtim me ligjin.

(2) Përmbajtjen dhe mënyrën e grumbullimit të të dhënave të paragrafit (1) të këtij neni, i përcakton ministri i Drejtësisë.

## Hulumtimi nacional

### Neni 31

(1) Enti Shtetëror i Statistikës zbaton hulumtim nacional për gjendjen me dhunën me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunën në familje.

(2) Hulumtimi ka për qëllim të sigurojë informata gjithëpërfshirëse për numrin e rasteve të formave të caktuara të dhunës në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunën në familje sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, pengesës, përkatësisë gjeografike të viktimës dhe kryerësit dhe informata të tjera relevante për ndjekje të gjendjes për dhunën ndaj femrave.

## Mbrojtja e të dhënave personale

### Neni 32

(1) Subjektet sipas nenit 11 dhe 24 të këtij ligji, grumbullojnë, përpunojnë, shfrytëzojnë, ruajnë dhe shlyejnë të dhëna personale në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

(2) Të dhënat personale të mbledhura në pajtim me këtë ligj, fshihen menjëherë në rastet kur do të përcaktohet se ato nuk janë të sakta ose kanë pushuar arsyet, përkatësisht kushtet për të cilat e dhëna personale është futur në evidencë.

(3) Të dhënat personale të grumbulluara në pajtim me këtë ligj, deri në shlyerjen e tyre, mund të jepen nën kushte të përcaktuara me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

(4) E drejta e subjektit të të dhënave personale për qasje dhe korrigjim të të dhënave personale me të cilat disponojnë subjektet e nenit 11 dhe 24 të këtij ligji, si dhe detyrimi për mbrojtjen e të dhënave personale sigurohen në kushtet e përcaktuara me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

(5) Subjektet e nenit 11 dhe 24 të këtij ligji, janë të detyruara të sigurojnë fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale të subjektit të të dhënave personale me çka patjetër të zbatojnë masat e duhura teknike dhe organizative për mbrojtjen nga zhdukja e rastësishme ose jo ligjore e të dhënave personale, ose humbja e tyre e rastësishme, ndryshimi, zbulim ose qasje e paautorizuar, në veçanti kur përpunimi përfshin bartje të të dhënave nëpërmjet rrjetit dhe mbrojtjen nga çdo formë e paligjshme e përpunimit.

## V. PREVENTIVË NGA DHUNA NË BAZË GJINORE NDAJ FEMRAVE DHE DHUNA NË FAMILJE

### Neni 33

(1) Organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale, sektori publik dhe privat, partitë politike, media, shoqatat dhe fondacionet, grupet joformale, partnerët socialë, sindikatat, organizatat fetare dhe organizatat e tjera, janë të detyruar të marrin masa parandaluese për ngritje të ndërgjegjes për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore bazuar në kulturën, zakonet, besimet, traditat dhe praktikatat e tjera të bazuara në idenë e nënshtrimit ndaj femrave dhe burrave.

(2) Mekanizmat për barazi gjinore në organet e administratës shtetërore dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale të përcaktuara me ligj, kryejnë koordinim dhe japin iniciativë për ndërmarrjen e masave parandaluese në pajtim me këtë ligj.



**Masa të përgjithshme preventive**

Neni 34

Subjektet e nenit 33 të këtij ligji, i ndërmarrin këto masa preventive të përgjithshme:

- 1) miratojnë program për planifikim dhe zbatim të masave dhe aktiviteteve parandaluese në pajtim me këtë ligj;
- 2) zbatojnë fushata për njohje të pasojave nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje;
- 3) vendosin sistem për publikim gjinor të informative për masa për siguri, këshille dhe informata të tjera të dobishme për preventivë nga dhuna dhe
- 4) bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjellë në promovimin dhe parandalimin nga dhuna në bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje.

**Ministria e Arsimit dhe e Shkencës**

Neni 35

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, përveç masave të përgjithshme parandaluese të nenit 34 të këtij ligji, i ndërmerr edhe këto masa të posaçme parandaluese:

- 1) miraton programe për barazinë midis femrave dhe meshkujve, zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, respektimin e diversitetit, promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore bazuar në kulturë, zakone, besim, traditat dhe praktika të tjera të bazuara në idenë e varësisë së femrave dhe burrave në institucionet për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore me propozim të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit;
- 2) fut përmbajtje në programet mësimore që promovojnë barazinë gjinore, zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, respektimin e diversitetit, informacion mbi të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe edukimin gjithëpërfshirës seksual në shkollat fillore dhe të mesme;
- 3) Fut përmbajtje në programet mësimore që promovojnë barazinë gjinore, zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, respektimin e diversitetit, informacion mbi të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe në arsimin për të ritur dhe
- 4) kryen edukim fillestar dhe të vazhdueshëm për personelin edukativ arsimor mbi barazinë gjinore, zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, respektimin e informacionit për diversitetin për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje dhe edukimin gjithëpërfshirës seksual nëpërmjet Byrosë së Zhvillimit të Arsimit.

**Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale**

Neni 36

Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, përveç masave të përgjithshme parandaluese të nenit 34 të këtij ligji, i ndërmerr edhe këto masa të posaçme parandaluese:

- 1) miraton programe për zgjidhjen jo të dhunshme të konflikteve, respektimin e diversitetit, promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore bazuar në kulturë, zakone, besim, traditat dhe praktika të tjera të bazuara në idenë e varësisë së femrave dhe burrave në institucionet për kujdesin dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes së Fëmijëve;
- 2) Siguron masa për përfshirjen e femrave viktime të dhunës në bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje në masa aktive për punësim, si dhe punësimin e tyre dhe

3) Zbaton fushata ose programe për ngritje të vetëdijes dhe mirëkuptimin e publikut të përgjithshëm për njohje dhe pasoja nga dhuna ndaj femrave dhe dhuna në familje.

**Mediet**

Neni 37

Mediet të themeluara në pajtim me Ligjin e Medieve i zbatojnë masat e përgjithshme parandaluese të nenit 34 pikat 2), 3) dhe 4) të këtij ligji, në pajtim me mundësitë e veta dhe në mënyrë të pavarur dhe politika e pavarur rregulluese, dhe ndërmarrin këto masat të posaçme parandaluese:

- 1) gjatë krijimit dhe transmetimin e programeve informuese dhe edukative, mbajnë përgjegjësi për ngritjen e vetëdijes tek publiku i gjerë për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje, promovimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore dhe
- 2) në mënyrë të pavarur ose nëpërmjet shoqatave profesionale të gazetarëve dhe punëtorëve të medias, vendosin bashkëpunim me shoqatat për forcimin e kapaciteteve të tyre për raportim profesional për çështje që lidhen me femrat dhe dhunën në familje.

**Bashkësitë fetare**

Neni 38

Kishat, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze janë të detyruara të përmbahen nga deklaratat, njoftimet ose deklaratat me të cilat arsyetohet dhuna me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhuna në familje si rezultat i religjionit, kulturës, traditës ose zakonisht.

**Trajtimi i kryerësve të dhunës në familje**

Neni 39

Trajtimi psikosocial i kryerësve të dhunës në familje sigurohet në qendër këshillimi për kryerësit e dhunës në pajtim me ligjin për mbrojtjen sociale dhe dispozitat nga sfera e mbrojtjes shëndetësore.

**VI. MBROJTJA E FEMRAVE VIKTIMA TË DHUNËS NË BAZË GJINORE DHE VIKTIMAVE TË DHUNËS NË FAMILJE****Denoncimi****Denoncimi nga qytetari**

Neni 40

(1) Çdo person fizik që është në dijeni të ekzistencës së dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje është i detyruar të denoncojë në stacionin policor, qendrën për punë sociale, prokurorinë publike, shoqatën ose linjën SOS.

(2) Institucionet kompetente të paragrafit (1) të këtij neni, janë të detyruara të veprojnë dhe pas denoncimit anonim.

**Denoncimi nga personat zyrtarë**

Neni 41

(1) Personi përgjegjës dhe personi udhëheqës i institucionit që kryejnë veprimtari në fushën e mbrojtjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve, punësimi, punët e brendshme, shëndeti dhe arsimit, janë të detyruar të denoncojnë njohuri për ekzistencën e dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje në stacion policor ose qendër për punë sociale.

(2) Çdo person përgjegjës dhe menaxhues në personin juridik është i detyruar të denoncojë njohuri për ekzistencën e dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje në stacionin policor ose qendrën për punë sociale.

(3) Çdo person përgjegjës dhe person udhëheqës në person juridik që ka dijeni të ekzistencës së dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunës në familje, e cila shkakton rrezik të menjëhershëm për jetën dhe trupin, është i detyruar të denoncojë në Prokurorinë Publike.

#### Neni 42

(1) Informacionet për viktimën ose kryerësin e dhunës, në bazë të të cilit mund të identifikohet viktimja ose anëtarët e familjes së saj, nuk mund të bëhet publike, përveç nëse viktimja pajtohet me të.

(2) Institucionet, prindërit, kujdestarët ose prindërit adoptues janë të detyruar ta mbrojnë fëmijën nga ekspozimi në publik.

### Shoqëruesi

#### Neni 43

(1) Viktimja ka të drejtë të zgjedhë personin i cili do ta shoqërojë gjatë procedurës para organit kompetent.

(2) Shoqëruesi mund të jetë çfarëdo personi në moshë, përveç personi i cili është kryerës i dhunës në bazë gjinore dhe/ose dhunë në familje në procedurë.

(3) Shoqëruesi e ndihmon viktimën në mbrojtjen e interesit të saj dhe jep mbështetje në procedurat para personave zyrtarë dhe institucioneve, dhe ndihmon për të gjetur zgjidhje për çështjen e saj dhe siguron mbështetje për viktimën.

(4) Personi zyrtar i cili e zbaton procedurën, nuk do të lejojë shoqëruesi të shoqërojë viktimën, në rast kur nuk i përmbush kushtet sipas paragrafit (2) të këtij neni, si dhe nëse vlerëson se shoqëruesi nuk mund ta mbështesë viktimën sipas paragrafit (3) të këtij neni, për shkak të marrëdhënieve familjare ose marrëdhënieve të tjera me viktimën ose kryerësin e dhunës ndaj femrave dhe / ose dhunës në familje.

(5) Fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuar ose të hequr pune, në procedurat para institucioneve kompetente shoqërohen nga prindi ose kujdestari, përveç prindit ose kujdestarit që është kryerës i dhunës ndaj femrave dhe / ose dhunës në familje.

## VII. MASA PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE

### Masa për mbrojtjen nga riviktimizimi

#### Neni 44

Institucionet kompetente të nenit 40 paragrafi (1) të këtij ligji, janë të detyruar të veprojnë me viktimat në mënyrë në të cilën do t'i mbrojnë në mënyrë plotësuere nga riviktimizimi ose riviktimizimi, duke marrë këto masa, në pajtim me kompetencat e tyre:

1) mbrojtja e identitetit dhe të dhënat personale të viktimës;

2) marrje e deklaratës në vendin e paraqitjes;

3) marrja e deklaratës së viktimës në stacion policor ose prokurori publike duke shfrytëzuar video dhe regjistrim të tonit i cili përdoret si dëshmi në procedurë me pëlqimin e dhënë më parë të viktimës;

4) bisedë në hapësira të posaçme të përshtatshme për bisedë me viktimja;

5) kufizim i ballafaqimit me të denoncuarin;

6) kufizim i dhënies së deklaratës më së shumti dy herë gjatë procedurës për mbrojtje nga dhuna dhe

7) masa të tjera me të cilat do të mbrohet integriteti i viktimës.

### Qendra e Punës Sociale

#### Neni 45

(1) Qendra e Punës Sociale është e detyruar të fillojë procedurë menjëherë, kurse më së voni në afat prej 12 orë nga njohuritë e marra se është kryer dhuna me bazë gjinore ndaj femrës ose dhunë në familje dhe të marrë masa për mbrojtjen e viktimës, sipas vlerësimit të rrezikut.

(2) Qendra e Punës Sociale e fillon procedurën pas marrjes së njoftimit se është kryer dhuna me bazë gjinore ndaj femrës ose dhunë në familje, sipas detyrës zyrtare, me kërkesë të viktimës, pas denoncimit të qytetarit, personit zyrtar, institucionit dhe shoqatës.

(3) Qendra e Punës Sociale, në rastet kur viktimja është fëmijë ose person i cili nuk është në gjendje të kujdeset për veten ose person me aftësi të kufizuar ose të privuar afariste, ndërmerr masa mbrojtëse, pavarësisht nëse ekziston pëlqimi i prindit ose kujdestarit.

#### Neni 46

Qendra e Punës Sociale i merr këto masa për mbrojtje të viktimave:

1) siguron akomodim të përkohshëm;

2) siguron që viktimja të marrë ndihmë të nevojshme mjekësore dhe sipas nevojës e shoqëron në institucionin shëndetësor më të afërt;

3) siguron që viktimja të realizojë të drejtën nga mbrojtja sociale dhe shëndetësore, në pajtim me ligjin;

4) jep intervencë përkatëse psikosociale dhe trajtim;

5) siguron viktimja të marrë trajtim psikosocial në qendra për këshilla nga persona profesional në qendrën për punë sociale, shoqatë, qendër për këshilla për femra viktimja të dhunës dhe viktimja të tjera të dhunës në familje;

6) siguron ndihmë familjes për shkollim të rregullt të fëmijës;

7) jep ndihmë juridike dhe përfaqësim;

8) e dërgon viktimën në organe përkatëse shtetërore dhe organe tjera kompetente për përforsim ekonomik të viktimës dhe përfshirjen e saj aktive në tregun e punës, nëpërmjet qendrës kompetente për punësim dhe

9) në rast rreziku të lartë dhe marrjes së masave urgjente për mbrojtje, si dhe kur viktimja përdor shërbime të qëndrimit të përkohshëm, kurse më së voni në afat prej 12 orësh nga marrja e paraqitjes, miraton aktvendim për besimin e përkohshëm të kujdesit dhe edukimit të fëmijëve të prindit viktimë.

#### Neni 47

(1) Qendra e Punës Sociale, kur si viktimë paraqitet fëmijë ose person i cili nuk është në gjendje të kujdeset për veten e tij ose personi të cilit aftësia afariste i është kufizuar ose hequr, krahas masave sipas nenit 46 të këtij ligji, ndërmerr masa në përputhje me Ligjin e Familjes, të cilat i referohen rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, kryerjen e mbikëqyrjes mbi të drejtën prindërore dhe kujdestarisë në përputhje me Ligjin për drejtësi për fëmijë.

(2) Në procedurat për besimin e fëmijës të njëri prej prindërve, Qendra e Punës Sociale e merr parasysh interesin e fëmijës, në mënyrë që do të kujdeset që të mos i rrezikojë të drejtat dhe sigurinë e viktimës dhe/ose fëmijëve.

(3) Qendra e Punës Sociale mund të kufizojë ose ndalojë përkohësisht marrëdhëniet personale dhe kontaktet e drejtpërdrejta të fëmijës me prindin me të cilin nuk jeton bashkë, në rast kur është në interes të fëmijës, derisa zgjat rreziku dhe pasojat e dhunës së kryer.

## Neni 48

(1) Qendra e Punës Sociale kur ka dijani se dhuna me bazë gjinore është kryer nga personi i cili zotëron armë zjarri, menjëherë e njofton Ministrinë e Punëve të Brendshme, kurse më së voni në afat prej 24 orëve dorëzon edhe njoftim me shkrim.

(2) Qendra e Punës Sociale çdoherë kur ka dijani se dhuna është kryer nga personi i cili ka qasje dhe menaxhon me armë zjarri zyrtare, menjëherë, kurse më së voni në afat prej 24 orësh, dorëzon njoftim me shkrim te institucionet ose personi juridik në të cilin personi është i punësuar dhe për këtë e informon Ministrinë e Punëve të Brendshme.

**Ministria e Punëve të Brendshme**

## Neni 49

(1) Nëpunësi policor, çdoherë kur ka denoncim për dhunë me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje, kurse për shkak të mënjanimin të rrezikut serioz dhe të drejtpërdrejtë për jetën dhe integritetin fizik dhe psikologjik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, është i detyruar të dalë në vendin e ngjarjes dhe të përgatisë raport policor menjëherë, kurse më së voni në afat prej 12 orëve nga intervenimi në ngjarje.

(2) Nëpunësi policor, në rastet e dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe dhunë në familje, kur ndërmerr punë policore dhe zbatim të autorizimeve policore, masa operative-teknike dhe parandaluese të përcaktuara me Ligjin për polici, çdo herë bën vlerësim të rrezikut për seriozitetin e rrezikut për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes dhe rrezikut të përsëritjes së dhunës, me qëllim që të mbrohet viktimata nëpërmjet menaxhimit adekuat me rrezikun.

(3) Nëpunësi policor siguron që viktimata menjëherë të marrë kujdesin e duhur shëndetësor sipas nenit 51 të këtij ligji.

(4) Nëpunësi policor, gjatë veprimit sipas paragrafit (1) të këtij neni, përkohësisht e merr armën nga kryerësi dhe ngrit procedurë të paraparë me ligjin për marrjen e lejes për armë, lejes për armë koleksioni, përkatësisht lejes për mbajtjen e armës.

(5) Nëpunësi policor, me kërkesë të viktimës, e shoqëron në vendbanimin e viktimës që të marrë sendet personale që janë të domosdoshme për jetën e përditshme, kurse nëse ajo është pamundësuar nga ana e kryerësit ose persona të tjerë që jetojnë në të njëjtin vendbanim, në bashkëpunim me prokurorin publik kompetent dhe me urdhër të lëshuar nga gjykata i merr sendet personale të viktimës;

(6) Në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, nëpunësi policor është i detyruar menjëherë, kurse më së voni në afat prej 12 orësh nga intervenimi i ngjarjes, ta informojë prokurorin publik kompetent.

(7) Nëpunësi policor është i detyruar që në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni te gjykata kompetente të dorëzojë propozim për shqiptimin e masës urgjente për mbrojtje-largim i kryerësit nga shtëpia dhe ndalim për afrim në shtëpi dhe raport policor të përgatitur nga nëpunësi policor.

(8) Nëpunësi policor është i detyruar në afatin e përcaktuar sipas paragrafit (1) të këtij neni, ta njoftojë qendrën kompetente të punës sociale për të marrë masa urgjente për mbrojtjen e viktimës.

(9) Nëpunësi policor kur do të vlerësojë se në vendngjarje ekziston rrezik i lartë i rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për jetën, integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, do të privojë nga liria kryerësin në përputhje me ligjin.

**Vlerësimi i rrezikut**

## Neni 50

(1) Institucionet kompetente sipas neneve 45 dhe 49 të këtij ligji, gjatë kryerjes së punëve nga kompetenca e tyre, janë të detyruar të bëjnë vlerësim të rrezikut nga rrezikshmëria serioze për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, vlerësimin e rrezikut të përsëritjes së dhunës me qëllim të rrezikut dhe sigurimin e masave për ndihmë të koordinuar dhe mbrojtje të viktimës.

(2) Vlerësimi i rrezikut bëhet urgjentisht në 12 orët e para nga denoncimi. Gjatë gjithë procedurës vlerësimi i rrezikut bëhet në bashkëpunim me viktimën, sipas nevojave të saj.

(3) Mënyrën e kryerjes së vlerësimit të rrezikut me rrezikshmëri serioze për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së viktimës dhe rrezikun e përsëritjes së dhunës, menaxhimin adekuat me rrezikun zbatimin e ndjekjes së masave për mbrojtje të femrave viktimata të dhunës me bazë gjinore dhe viktimata të dhunës në familje, të ndërmarra nga Qendra e Punës Sociale dhe formularët e nevojshëm i përcakton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

(4) Mënyrën e vlerësimit të rrezikut me rrezikshmëri serioze për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së viktimës dhe rrezikun e përsëritjes së dhunës, menaxhimin adekuat me rrezikun, formën e raportit policor dhe propozimin për shqiptimin e masës urgjente për mbrojtje, largimin e kryerësit nga shtëpia dhe ndalimin për afrim deri te shtëpia e përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

**Institucionet shëndetësore**

## Neni 51

(1) Institucioni shëndetësor dhe punëtorët shëndetësorë janë të detyruar që menjëherë të ndërmarrin masa për mbrojtjen e viktimës, edhe atë:

- kontroll të lëndimeve dhe sigurimin e trajtimit mjekësor,

- i dokumentojnë lëndimet dhe mbledhin dëshmi për ekzistimin e shkeljes të integritetit trupor dhe psikik,

- lëshojnë dokumentacion mjekësor për lëndimin e konstatuar që përshkruan qartë dhe kuptueshëm llojin dhe vëllimin e lëndimeve,

- i informojnë viktimat për të drejtat e tyre, procedurat për mbrojtje dhe shërbimet e arritshme për ndihmë dhe përkrahje dhe

- ndërmerr masa tjera për mbrojtjen e viktimave në pajtim me nevojat e viktimave.

(2) Për masat sipas paragrafit (1) të këtij neni, viktimat lirohen nga pagesa e shpenzimeve.

(3) Masat për mbrojtjen shëndetësore të femrave viktimata të dhunës dhe viktimave të dhunës në familje sipas paragrafit (1) të këtij neni sigurohen nëpërmjet programit vjetor, të cilin e miraton ministri i Shëndetësisë.

## Shoqatat

### Neni 52

(1) Shoqata, mund të ndërmarrë masa për mbrojtje sipas nenit 46, pikat 1, 2, 4, 5, 7 dhe 8 të këtij ligji, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me qendrën kompetente për punë sociale.

(2) Shoqata është e detyruar të ndërmarrë masa për mbrojtje sipas paragrafit (1) të këtij neni, në afat prej 24 orëve nga ndërmarrja e masave e njofton Qendrën e Punës Sociale kompetente sipas vendbanimit të viktimës.

## Njësitë e vetëqeverisjes lokale

### Neni 53

(1) Njësitë e vetëqeverisjes lokale janë të detyruara në buxhet të sigurojnë mjete për përkrahje financiare për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

(2) Vëllimi, përfshirja, lartësia dhe kohëzgjatja e përkrahjes financiare për viktimat, i rregullon çdo njësi e vetëqeverisjes lokale në pajtim me ligjin

## Institucionet arsimore-edukative

### Neni 54

Institucionet arsimore-edukative në rajonin e njërive të vetëqeverisjes lokale janë të detyruar të sigurojnë regjistrim urgjent të fëmijëve viktimat të dhunës në shkolla ose kopshte në territorin e saj pa u kërkuar pëlqim nga të dy prindërit.

## Ekipi profesional shumësektorial

### Neni 55

(1) Në rastet kur ka njohuri për rrezikimin e jetës dhe shëndetit të femrave viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje dhe anëtarëve të familjes, përgatitet plan i sigurisë për ndihmë, nga ekipi profesional shumësektorial.

(2) Qendra kompetente për punë sociale, sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të viktimës, formon ekip profesional shumësektorial sipas paragrafit (1) të këtij neni, i cili është i përbërë nga persona profesionistë nga Qendra e Punës Sociale, stacioni policor kompetent dhe institucioni shëndetësor, me qëllim të ndërmarrjes së veprimtarive të koordinuara në sigurimin e ndihmës viktimës në përputhje me nevojat e saj.

(3) Në punën e ekipit profesional shumësektorial sipas paragrafit (2) të këtij neni, marrin pjesë përfaqësues të shoqatave, të cilat mund të propozojnë dhe zbatojnë masa dhe aktivitete nga plani i sigurisë për ndihmë të viktimave.

(4) Në rast kur ekziston njohuri për rrezikun e jetës dhe shëndetit të fëmijës, ekipi profesional shumësektorial në planin e sigurisë për ndihmë të prindit parashikon masa dhe aktivitete që duhet të zbatohen për ndihmë të fëmijës.

### Neni 56

Të gjitha masat dhe shërbimet për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunë në familje të parashikuara me këtë ligj, të cilat janë në dispozicion të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë në dispozicion në mënyrë të barabartë dhe për refugjatët, azilkërkuesit, personat pa shtetësi dhe personat pa dokumente ose identifikim personal, pavarësisht nga procedura për rregullimin e statusit të tyre.

## VIII. MASA URGJENTE DHE TË PËRKOHSHME PËR MBROJTJE

### Masa urgjente

#### Neni 57

(1) Për mënjanim të rrezikut të drejtpërdrejtë dhe serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj, shqiptohet masa urgjente për mbrojtje dhe atë largimi i kryerësit nga shtëpia dhe ndalimi për afrim deri të shtëpia me propozim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, pa pajtim të viktimës.

(2) Propozimin për shqiptimin e masës urgjente për mbrojtje, Ministria e Punëve të Brendshme e dorëzon te gjykata kompetente pas vlerësimit të bërë të rrezikut sipas nenit 50 paragrafi 2 të këtij ligji dhe raportit policor sipas nenit 49 paragrafi 7 të këtij ligji.

(3) Masa urgjente për mbrojtje sipas paragrafit (1) të këtij neni shqiptohet në kohëzgjatje prej së paku dhjetë, e më së shumti deri në 30 ditë.

### Masa të përkohshme për mbrojtje

#### Neni 58

Për të ndaluar dhunën, mënjanimin e pasojave të dhunës së kryer dhe për të ndërmarrë masa efikase kundër kryerësit të dhunës, për shkak të eliminimit të arsyeve për kryerjen e sërishme të dhunës, kryerësit të dhunës me bazë gjinore ndaj femrave dhe viktimat e dhunës në familje gjykata mund t'i shqiptojë masat e përkohshme për mbrojtje si vijojnë:

- 1) ndalim që të kërcënohet se do të kryejë dhunë;
- 2) ndalim që ta keqtrajtojë, shqetësojë, telefonojë, kontaktojë ose në mënyrë tjetër të komunikojë drejtpërdrejt ose indirekt me viktimën;
- 3) ndalim që të afrohet në distancë më të vogël se 100 metra nga vendbanimi, shkolla, vendi i punës ose vendi i caktuar që viktimat e viziton rregullisht;
- 4) largim nga shtëpia pavarësisht nga pronësia, në kohëzgjatje prej 10 deri në 30 ditë;
- 5) ndalim të posedojë armë zjarri ose armë tjetër ose e njëjta t'i merret;
- 6) detyrimisht të kthejë sendet të cilat janë të nevojshme për të përbushur nevojat ditore të viktimës dhe familjes;
- 7) mbajtje e detyrueshme ligjore e familjes;
- 8) detyrimisht të vizitohet qendër këshillimi për kryerësit e dhunës ndaj femrave - ose dhunës në familje;
- 9) mjekim i detyrueshëm i kryerësit, nëse abuzon me alkool, drogë dhe substanca të tjera psikotrope ose ka sëmundje psikike;
- 10) kryerësi detyrimisht t'i kompensojë shpenzimet mjekësore dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara nga dhuna dhe

11) çdo masë tjetër që gjykata e konsideron të domosdoshme që të sigurojë siguri dhe mirëqenie të viktimës dhe anëtarëve të tjerë të familjes.

(2) Në procedurat në të cilat gjykata vendos për masa të përkohshme për mbrojtje zbatohen dispozitat e ligjit për procedurë kontestimore, përveç nëse me këtë ligj nuk rregullohet ndryshe.

#### Neni 59

(1) Ministria e Punëve të Brendshme është e detyruar të paraqesë propozim për shqiptimin e masës urgjente për mbrojtje sipas nenit 57 të këtij ligji, te gjykata kompetente për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhe rrezikut serioz për jetën dhe integritetin fizik dhe psikik të viktimës dhe anëtarëve të familjes së saj.

(2) Viktima mund të paraqesë propozim për shqiptimin e masës së përkohshme të mbrojtjes sipas nenit 58 të këtij ligji, te gjykata kompetente drejtpërdrejt ose nëpërmjet Qendrës së Punës Sociale, me kërkesë të saj.

(3) Qendra e Punës Sociale mund të paraqesë propozim për shqiptimin e masës së përkohshme të mbrojtjes sipas nenit 58 të këtij ligji, te gjykata kompetente me pëlqim të viktimites.

(4) Prindi ose kujdestari mund të paraqesë propozim për shqiptimin e masës së përkohshme të mbrojtjes sipas nenit 58 të këtij ligji, në emër të fëmijës së mitur dhe personit me aftësi të kufizuar ose me aftësi pune të hequr, si dhe për person mbi të cilin është vazhduar e drejta prindërore.

(5) Qendra e Punës Sociale detyrimisht i paraqet gjykatës propozimin për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji, në emër të fëmijëve dhe personave të paaftë për punë sa herë që prindi, kujdestari ose përfaqësuesi ligjor nuk e bëjnë këtë edhe pa pëlqimin e tyre.

(6) Qendra e Punës Sociale, në propozimin e gjykatës për shqiptimin e masës së përkohshme të mbrojtjes sipas nenit 58 të këtij ligji, për fëmijë, mund të propozojë që masa e përkohshme e mbrojtjes t'i referohet prindit me të cilin jeton fëmija, në rastet kur këtë e kërkojnë interesat e fëmijës për mbrojtjen dhe sigurinë e tij.

#### Neni 60

Qendra e Punës Sociale me propozimin për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji, dorëzon konstatim dhe mendime të ekipit profesional, i cili jep propozim për shqiptimin e masës së përkohshme, në varësi të nevojave të konstatuara për mbrojtjen e viktimites.

#### Neni 61

Propozimi për shqiptimin e masës së përkohshme mund të paraqitet pavarësisht nëse zhvillohet procedurë penale.

#### Neni 62

(1) Masa e përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji mund të zgjasë së paku tre muaj kurse më së shumti deri një vit.

(2) Nëse dhuna vazhdon pas kalimit të periudhës për të cilën është shqiptuar masa e përkohshme për mbrojtje në suaza të afatit prej një viti sipas paragrafit (1) të këtij neni, viktima ose Qendra e Punës Sociale mund të paraqesë kërkesë për vazhdimin e masës/ave.

(3) Pas kalimit të një viti nga masa e shqiptuar e përkohshme për mbrojtje sipas paragrafit (1) të këtij neni, në rast kur dhuna ndaj femrave dhe dhuna në familje do të përsëriten përsëri, viktima ose Qendra e Punës Sociale paraqet propozim të ri te gjykata.

#### Neni 63

(1) Viktima ose Qendra e Punës Sociale mund të paraqesë propozim te gjykata kompetente për heqjen e masës së përkohshme të shqiptuar për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji dhe para skadimit të afatit për të cilin është shqiptuar masa, nëse vlerësohet se e njëjta ka arritur qëllimin për shkak të së cilës është shqiptuar.

(2) Viktima ose Qendra e Punës Sociale mund të paraqesin propozim për ndryshimin e masës së përkohshme të shqiptuar të mbrojtjes sipas nenit 58 të këtij ligji ose për vazhdimin e saj, nëse masa e shqiptuar nuk ka siguruar mbrojtje adekuate të viktimites ose kanë ndodhur rrethana të ndryshuara.

### Shqiptimi i masave të përkohshme për mbrojtje

#### Neni 64

Në procedurat në të cilat gjykata vendos për masa të përkohshme për mbrojtje zbatohen dispozitat e ligjit për procedurë kontestimore, nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe.

#### Neni 65

(1) Në procedurat e shqiptimit të masave të përkohshme për mbrojtje gjinore të bazuar në dhunën ndaj femrave dhe dhunën në familje vendos gjykatësi individ.

(2) Në procedurat e paragrafit (1) të këtij ligji, publiku është përjashtuar në seancën gjyqësore.

(3) Me përjashtim të paragrafit (2) të këtij neni, gjykatësi mund të lejojë që në seancën gjyqësore të marrin pjesë punëtorë shkencorë dhe publikë, të cilët merren me problemet e martesës dhe familjes, si dhe persona që palët do t'i propozojnë.

#### Neni 66

(1) Gjykata, menjëherë ose më së voni në afat prej 24 orësh pas pranimit të propozimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe raportit policor, pa mbajtur seancë gjyqësore do të vendosë për shqiptimin e masës urgjente për mbrojtje, largimin e kryerësit nga shtëpia dhe ndalesë për afrim afër shtëpisë sipas nenit 57 të këtij ligji.

(2) Gjykata me propozim të viktimites ose qendrës për punë sociale për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji, do të veprojë menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës do të marrë vendim.

(3) Gjykata në afat prej 24 orësh, pa mbajtur seancë gjyqësore, do të vendosë për shqiptimin e masës urgjente për mbrojtje sipas nenit 57 të këtij ligji, kur ekziston bazë e dyshimit për rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e viktimites ose të ndonjë anëtarit të familjes, në bazë të konstatimit profesional dhe mendimit të qendrës për punë sociale.

#### Neni 67

(1) Seanca gjyqësore mbahet në prani të viktimites, kundërshtarit (kryerësit të dhunës së bazuar gjinore ndaj femrës dhe dhunës në familje) dhe përfaqësuesi i qendrës së punëve sociale, kur është parashtrues i propozimit për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji.

(2) Kur viktima është fëmijë ose personi me aftësi të kufizuara ose i është hequr aftësia për punë, në seancën gjyqësore përfaqësohet nga prindi që nuk është kundërshtar në procedurë ose tutori.

(3) Thirrjen për mbajtjen e seancës gjyqësore, gjykata ia dorëzon kundërshtarit në afat prej dy ditësh nga dita e pranimit të propozimit.

(4) Me vlerësim të gjykatës, mund të thirren edhe persona të tjerë në seancën gjyqësore.

(5) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, kur ekziston dyshimi i bazuar për rrezik serioz për jetën dhe shëndetin e viktimites ose të anëtarit të familjes gjykata mund të shqiptojë masë urgjente për mbrojtje sipas nenit 57 të këtij ligji, në mungesë të kundërshtarit dhe në bazë të konstatimit gjyqësor dhe mendimit të qendrës për punë sociale, nëse nuk merren prova tjera.

#### Neni 68

Gjykata me propozim të qendrës për punë sociale përkatësisht të femrës, viktimites bazuar në dhunë gjinore dhe viktima e dhunës në familje, mund ta vazhdojë, anulojë ose ndryshojë masën e shqiptuar të përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji.

## Neni 69

Në vendimin i cili është shqiptuar me masë urgjente për mbrojtjen sipas nenit 57 të këtij ligji dhe masa e përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji, gjykata do ta angazhohet kryerësin e dhunës së bazuar gjinore ndaj femrës dhe viktimës së dhunës në familje ta respektojë vendimin gjyqësor.

## Neni 70

(1) Vendimi për masë urgjente të shqiptuar për mbrojtje, largimin e kryerësit nga shtëpia dhe ndalesë për t'iu afruar afër shtëpisë sipas nenit 57 të këtij ligji, gjykata në afat prej 6 orëve nga miratimi i vendimit e dorëzon në stacionin përkatës të policisë sipas vendit të realizimit, të cilin menjëherë ose më së voni në afat prej 12 orësh pas pranimit të vendimit, e dorëzon deri te kryerësi i dhunës së bazuar gjinore mbi gruan dhe viktimë tjetër të dhunës në familje.

(2) Në rast kur dërgesa nuk mund të realizohet në afatin sipas paragrafit 1 të këtij neni, gjykata pas informatës së marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme, vendimin e publikon në tabelën e shpalljeve, me të cilën llogaritet se dërgesa është në rregull.

(3) Ministria e Punëve të Brendshme është e detyruar ta largojë kryerësin nga shtëpia në afat prej dy orësh, duke llogaritur momentin kur i është dorëzuar vendimi për masën mbrojtëse urgjente të shqiptuar për mbrojtje, largim të kryerësit nga shtëpia dhe ndalesë për afrim afër shtëpisë sipas nenit 57 të këtij ligji, në rast kur nuk dëshiron vullnetarisht ta lëshojë shtëpinë.

## Neni 71

(1) Një ekzemplar të vendimit për masën urgjente për mbrojtje largim të kryerësit nga shtëpia dhe ndalesë për afrim afër shtëpisë sipas nenit 57 të këtij ligji, gjykata e dorëzon në prokurorinë publike dhe në qendrën për punës sociale.

(2) Një ekzemplar për vendimin për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji, gjykata ia dorëzon palëve, qendrës për punës sociale dhe institucionit, kompetent për realizimin e masave mbrojtëse të përkohshme.

## Neni 72

(1) Ankesa kundër vendimit të gjykatës themelore për shqiptimin e masës urgjente për mbrojtje, largimin e kryerësit nga shtëpia dhe ndalesë për afrim afër shtëpisë sipas nenit 57 të këtij ligji ose masë të përkohshme ndalesë për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji, mund të parashtrohet në afat prej tri ditëve nga dita e pranimit të vendimit.

(2) Ankesa e paraqitur kundër vendimit të gjykatës nuk e prolongon zbatimin e saj.

### Realizimi i masës urgjente dhe masave të përkohshme për mbrojtje

## Neni 73

(1) Ministria e Punëve të Brendshme e realizon masën e shqiptuar urgjente për mbrojtje largim të kryerësit nga shtëpia dhe ndalesë për afrim afër shtëpisë sipas nenit 57 të këtij ligji dhe masat e përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 paragrafi 1 pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, Ministria e Shëndetësisë e realizon masën e përkohshme të shqiptuar për mbrojtje sipas nenit 58 paragrafi 1 pika 9 të këtij ligji, këshillimorja për kryerësit e dhunës në familje realizon

masën e përkohshme të shqiptuar sipas nenit 58 paragrafi 1 pika 8 të këtij ligji, ndërsa realizimin për masat e shqiptuara të përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 paragrafi 1 pikat 6,7,10 dhe 11 të këtij ligji, zbatohen sipas ligjit.

(2) Këshillimorja për kryerësit e dhunës së bazuar gjinore dhe dhunës në familje, ekzekuton vendim gjyqësor për mbikëqyrje të mbrojtur në pjesën e obligimit të përcaktuar për personin e gjykuar për veprën penale gjatë dhunës së bazuar në gjini dhe dhunës në familje për vizitën e programit për punë me të dënuar për vepra penale gjatë kryerjes së dhunës së bazuar gjinore dhe dhunës në familje dhe e informon gjykatën për plotësimin e obligimit.

## Neni 74

(1) Mënyra e realizimit të masës së shqiptuar urgjente për mbrojtje largimin e kryerësit nga shtëpia dhe ndalesa për afrim afër shtëpisë sipas nenit 57 të këtij ligji dhe masat e përkohshme në mbrojtjen e nenit 58 paragrafi (1) pikat 1), 2), 3), 4) dhe 5) të këtij ligji i përcakton ministri i Punëve të Brendshme.

(2) Mënyrën e realizimit të masës së përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 paragrafi (1) pika 9) të këtij ligji e përcakton ministri i Shëndetësisë.

(3) Mënyrën e realizimit të masës së përkohshme për mbrojtje sipas nenit 55 paragrafi (1) pika 8) të këtij ligji e përcakton ministri i Punës dhe i Politikës Sociale.

## Neni 75

(1) Qendra e Punës Sociale e përcjell realizimin e masës së përkohshme të shqiptuar për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji.

(2) Për përcjelljen e masave të përkohshme për mbrojtje sipas paragrafit (1) të këtij neni, Qendra e Punës Sociale bashkëpunon me qytetarë, persona juridikë, institucione dhe shoqata.

(3) Qendra e Punës Sociale e informon gjykatën për rrjedhën e efekteve për masën e përkohshme të shqiptuar për mbrojtje sipas nenit (1) të këtij ligji.

## Neni 76

(1) Gjukata mund të kërkojë informatë nga Ministria e Punëve të Brendshme për mënyrën e zbatimit dhe respektimit të masës së shqiptuar urgjente për mbrojtje largim të kryerësit nga shtëpia dhe ndalesë të afrimit afër shtëpisë sipas nenit 57 të këtij ligji.

(2) Gjukata mund të kërkojë informatë nga qendra për punës sociale për zbatimin e masës së shqiptuar të përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji, gjatë periudhës së përcjelljes.

## Neni 77

Viktima e informon qendrën për punës sociale për mosrespektimin ose shkeljen e masës së përkohshme të shqiptuar për mbrojtjen sipas nenit 58 të këtij ligji, në procedurë me propozim të tij.

## Neni 78

(1) Ministria e Punëve të Brendshme është e obliguar menjëherë ta informojë gjykatën për mosrespektimin ose shkeljen e masës së shqiptuar urgjente për mbrojtje sipas nenit 57 të këtij ligji.

(2) Qendra e Punës Sociale është e obliguar menjëherë ta informojë gjykatën për mosrespektimin ose shkeljen e masës së shqiptuar të përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji.

## Neni 79

Ministria e Punëve të Brendshme, kur shkelet masa urgjente për mbrojtje sipas nenit 57 të këtij ligji në pjesën e ndalesës për afrim afër shtëpisë do të dorëzojë propozim në prokurorinë publike për përcaktimin e masave për kujdes, në pajtim me Ligjin i Procedurës Penale.

## Neni 80

(1) Qendra është e obliguar të parashtojë kërkesë kundër kryerësit për mosrespektimin e vendimit gjyqësor për shqiptimin e masës së shqiptuar të përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji.

(2) Qendra është e obliguar të ngritë padi penale kundër kryerësit për mosrespektimin e vendimit gjyqësor për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji, çdo herë kur dhuna është kryer mbi fëmijë ose në prani të fëmijës.

(3) Prokurori publik është i obliguar me shkrim ta informojë qendrën për punë sociale për procedurën e iniciuar penale, me padi penale sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni.

## Neni 81

Mënyra e zbatimit dhe mënyra e përcjelljes së masave të shqiptuara përkohësisht për mbrojtje sipas nenit 58 të këtij ligji i përcakton ministri i Punës dhe e Politikës Sociale.

## IX. MBROJTJA GJYQËSORE

## Mbrojtja gjyqësore e viktimave

## Neni 82

(1) Viktimat kanë të drejtë në mbrojtje gjyqësore, në procedurë qytetare dhe procedurë penale para gjykatave vendore dhe kompetencës tokësore.

(2) Viktimat kanë të drejtë në masa të veçanta në mbrojtje të procesit në pajtim me Ligjin e procedurës penale dhe Ligjin i të Dejtave të Fëmijëve.

## Padi për përcaktimin e përgjegjësisë për mosveprim me kujdes të veçantë

## Neni 83

(1) Viktima ka të drejtë të ngrejë pati para gjykatës qytetare për përcaktimin e përgjegjësive për mosveprim me kujdes të veçantë për subjektet sipas nenit 4 të këtij ligji.

(2) Në padinë sipas paragrafit (1) të këtij neni mund të theksohet kërkesa:

1) të përcaktohet përgjegjësia e personit të paditur për mosveprim me kujdes të veçantë të përcaktuar me këtë ligj;

2) të gjykohet për kompensimin e demit të viktimës për shkak të mosveprimit me kujdes të veçantë të personit të paditur dhe

3) të obligohet i padituri që të ndërmer veprime për mbrojtjen e viktimës në pajtim me dispozitat dhe afatet e përcaktuara me këtë ligj.

(3) Në procedurën përkatëse zbatohen dispozitat e Ligjit i Procedurës Kontestimore, përpos nëse me këtë ligj nuk është ndryshe e rregulluar.

## Kompetenca vendore

## Neni 84

Në të gjitha procedurat qytetare për mbrojtjen e viktimave të dhunës së bazuar gjinore dhe dhunës në familje gjykata vendase është kompetente, krahas gjykatës me kompetencë të përgjithshme vendase, edhe gjykata në rajonin e të cilit është vendbanimi, vendqëndrim i paraqitur i personit të paditur ose selia e qendrës për vendosje ku është e vendosur viktima.

## Ngarkesa e dëshmisë

## Neni 85

Paditësi i cili pohon se në pajtim me dispozitat e këtij ligji është shkelur parimi i kujdesit të veçantë, është i obliguar t'i nxjerr faktet që e bëjnë pohimin e besueshëm dhe atëherë ngarkesa e dëshmisë kalon tek i padituri që të dëshmojë se ka vepruar me kujdes të duhur.

## Zgjidhja e kontesteve me marrëveshje

## Neni 86

Në procedurat të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e viktimave, gjykata nuk mund të udhëzojë në zgjidhje të detyrueshme me marrëveshje të kontestit.

## Dëshmipërblimi i viktimave

## Neni 87

(1) Viktimat kanë të drejtë në kompensim të dëmeve materiale dhe materiale në pajtim me ligjin.

(2) Viktima e cila kërkesat e veta pronësore juridike të gjykuara me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk mund t'i arkëtojë nga kryerësi, do të mund të kërkojë që e njëjta t'i paguhet nga fondi shtetëror në pajtim me ligjin.

(3) Viktimat janë liruar nga pagesa i të gjitha harxhimeve në procedurat për kompensim të demit deri në arkëtimin përfundimtar të kërkesave pronësore juridike në pajtim me ligjin.

## X. SHËRBIME PËR FEMRAT VIKTIMA TË DHUNËS GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE

## Shërbime të përgjithshme për viktimat

## Neni 88

(1) Femrat viktima të dhunës gjinore dhe dhunës në familje kanë qasje në shërbime shëndetësore dhe sociale.

(2) Nëpunësit zyrtarë në institucionet të cilat japin shërbime shëndetësore dhe sociale janë të obliguar t'i japin përkrahje dhe ndihmë, dhe t'i udhëzojnë tek dhënësit tjerë të shërbimeve të specializuara përkatëse.

## Shërbime të specializuara për viktimat

## Neni 89

(1) Shërbimet e specializuara për femra viktima të dhunës së bazuar gjinore dhe dhunës në familje janë shërbime të cilat i përshtaten nevojave konkrete të viktimave të llojeve të ndryshme të dhunës;

(2) Shërbimet e specializuara nga paragrafi (1) të këtij neni, sigurohen pa kompensim, në mënyrë që të ruhet privatësia, dinjiteti dhe reputacioni i viktimave;

(3) Shërbimet e specializuara sipas paragrafit (1) të këtij neni, janë të arritshme për të gjitha viktimat duke përfshirë edhe fëmijët e tyre pavarësisht vullnetit të viktimës që të dëshmojë në procedurë kundër kryerësit.

(4) Shërbimet e specializuara sipas paragrafit (1) të këtij neni, financohen nga mjetet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga buxheti i njërive të vetëqeverisjes lokale dhe burime të tjera të financimit.

#### **Shërbime të informimit dhe udhëzimit**

##### **Neni 90**

(1) Shërbimi i informimit dhe udhëzimit sigurohet nëpërmjet linjës S.O.S.

(2) Linja S.O.S., 24 orë siguron informatë të saktë, në kohë dhe të besueshme për mbrojtjen e viktimave, shërbimeve të arritshme dhe këshilla me telefon për femrat viktimat të dhunës dhe viktimat e dhunës në familje.

(3) Shërbimi sipas paragrafit (1) të këtij neni sigurohet nga dhënësit e shërbimeve speciale, në pajtim me Ligjin e Mbrojtjes Sociale.

#### **Shërbimi për këshillim**

##### **Neni 91**

(1) Shërbimi këshillim përfshin mbështetjen psikosociale, këshillimin dhe trajtimin e femrave viktimat të dhunës me bazë gjinore, fëmijëve viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe viktimave të dhunës në familje.

(2) Shërbimi për këshillim të fëmijëve viktimat të keqpërdorimit, neglizhencës dhe dhunës sigurohet nëpërmjet zbatimit të planit individual të përpiluar nga Qendra e Punës Sociale në përputhje me Ligjin për mbrojtjen sociale.

(3) Shërbimet e fëmijëve viktimat të veprave penale sipas paragrafit (2) të këtij neni, sigurohen në përputhje me Ligjin i Drejtësisë për Fëmijët.

(4) Në kuadër të shërbimit për këshillim, viktimat mund të marrin edhe udhëzim dhe / ose shoqërim në institucionet ose shoqatat në përputhje me Ligjin i Mbrojtjes Sociale.

#### **Shërbimi për qëndrim të përkohshëm**

##### **Neni 92**

(1) Shërbimi për qëndrimin e përkohshëm siguron akomodim në qendrën për qëndrim të përkohshëm kur ekziston njohuri për kërcënimin real për jetën dhe shëndetin e viktimës ose në mungesë të resurseve të tjera për akomodimin e kategorive të personave si në vijim:

1) femrat viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje dhe fëmijët e tyre;

2) femrat viktimat të dhunës seksuale dhe përdhunimit;

3) viktimat e tregtisë me njerëz;

4) viktimat e dhunës për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

(2) Akomodimi ndërhyrës sigurohet në gjendje akute të dhunës kur ekziston kërcënimin real serioz për jetën dhe shëndetin e viktimës në kohëzgjatje prej 24 deri në 72 orë.

(3) Përveç akomodimit, në qendrën sipas paragrafit (1) të këtij neni viktimat marrin mbrojtje, ndihmë dhe mbështetje psikosociale, trajtim për tejkalimin e traumës, këshillim juridik, përfshirje në masat aktive të punësimit të viktimës me qëllim që të përfshihet në tregun e punës dhe arritjen e pavarësisë financiare dhe shërbimeve të tjera në varësi të nevojave të viktimës, në përputhje me ligjin.

(4) Shërbimi i qëndrimit të përkohshëm mund të zgjasë më së shumti tre muaj me mundësinë e vazhdimet më së shumti deri në një vit.

##### **Neni 93**

Shërbimet e specializuara nga nenet 90, 91 dhe 92 të këtij ligji, i siguron Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe dhënësit e tjerë të shërbimeve sociale në përputhje me normativat dhe standardet për dhënie e shërbimeve sociale në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale.

#### **Shërbimi për mbrojtjen dhe mbështetjen e femrave viktimat të dhunës seksuale dhe përdhunimit**

##### **Neni 94**

(1) Shërbimi për mbrojtjen dhe mbështetjen e femrave viktimat të dhunës seksuale dhe përdhunimit kryhet në kuadër të qendrës për këshillimin e viktimave të dhunës seksuale.

(2) Në institucionin shëndetësor sipas paragrafit (1) të këtij neni, sigurohet identifikimi, vlerësimi, kontrolli mjekësor, mbështetja e krizës psikologjike, këshillimi i femrave viktimat të dhunës seksuale dhe përdhunimit.

(3) Shërbimi sipas paragrafit (1) të këtij neni, sigurohet në përputhje me procedurën operative standarde të cilën e miraton ministri i Shëndetësisë.

#### **Shërbimi për trajtim afatgjatë të femrave viktimat të dhunës seksuale dhe përdhunimit**

##### **Neni 95**

(1) Shërbimi për trajtimin afatgjatë të femrave viktimat të dhunës seksuale dhe përdhunimit sigurohet në qendrën për këshillim afatgjatë dhe psikoterapi të femrave viktimat të dhunës seksuale dhe përdhunimit.

(2) Shërbimi sipas paragrafit (1) të këtij neni, përfshin psikoterapinë individuale dhe / ose grupe, këshillimin psikosocial, lidhjen me shërbimet e tjera të përgjithshme dhe të specializuara, shoqërimin në institucionet dhe organizatat dhe përfaqësimin e viktimave në institucionet dhe organizatat e tjera.

(3) Shërbimi sipas paragrafit (1) të këtij neni, sigurohet në përputhje me procedurën operative standarde të cilën e miraton ministri i Shëndetësisë.

##### **Neni 96**

Shërbimet e specializuara nga nenet 94 dhe 95 të këtij ligji, i siguron Ministria e Shëndetësisë në përputhje me rregullat në fushën e mbrojtjes shëndetësore.

#### **Shërbimi për ndihmë juridike falas**

##### **Neni 97**

(1) Shërbimi për ndihmën juridike falas sigurohet në përputhje me ligjin.

(2) Shoqatat mund të sigurojnë shërbim për ndihmë juridike falas për femrat viktimat të dhunës dhe viktimat e dhunës në familje të financuara edhe nga burimet e tjera.

#### **Dhënësit e shërbimeve**

##### **Neni 98**

Shërbimet e specializuara mund të sigurohen nga dhënësit e shërbimeve të specializuara: institucionet në sistemin e mbrojtjes sociale, institucionet shëndetësore, shoqatat, njësitë e vetëqeverisjes lokale, personat juridikë dhe fizikë vendas dhe të huaj, në kushtet e përcaktuara me ligj.



**Riintegrimi i viktimave të dhunës**

## Neni 99

(1) Subjektet sipas nenit 11 dhe nenit 24 të këtij ligji, janë të detyruara në kuadër të kompetencave të tyre, të kujdesen për procesin e riintegritimit të viktimave të dhunës nëpërmjet njohjes së viktimave si kategori e veçantë e rrezikueshme dhe zhvillimit të programeve dhe masave për ndihmën dhe mbështetjen në bazë të nevojave të tyre.

(2) Programi për riintegrimin e viktimave të dhunës përfshin modele për banimin e përkohshëm, këshillimin psikologjik me mentorim, llojet e ndryshme të ndihmës financiare të dedikuara për femrat viktime të dhunës, mundësitë për arsim dhe trajnim në fusha të ndryshme, si dhe masat e punësimit të përcaktuara me ligj.

(3) Masat e punësimit dhe masat e tjera për ndihmë dhe mbështetje sipas paragrafit (1) të këtij neni, duhet të përshtrahen në përputhje me nevojat specifike të viktimave.

(4) Programin për riintegrimin e viktimave të dhunës e miraton ministri i Punës dhe Politikës Sociale.

**XI. MBIKËQYRJA MBI ZBATIMIN E KËTIJ LIGJI**

## Neni 100

(1) Mbiqëqyrje mbi zbatimin e dispozitave sipas neneve 40 paragrafi (2), 41, 45, 46, 47, 48, 50, 55 paragrafi (2) dhe (4), 59 paragrafët (3), (5) dhe (6), 60, 72, 75, 76 paragrafi (2), 78 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara sipas neneve 26 paragrafi (6), 50 paragrafi (3), 74 paragrafi (3), 81 dhe 99 paragrafi (4) të këtij ligji kryen Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale.

(2) Mbiqëqyrje mbi zbatimin e dispozitave sipas neneve 40 paragrafi (2), 41, 44, 49, 50, 57, 58, 59 paragrafi (1), 73 paragrafi (1), 78 paragrafi (1) dhe 79 të këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara sipas neneve 50 paragrafi (4) dhe nenit 74 paragrafi (1) të këtij ligji kryen Ministria e Punëve të Brendshme.

(3) Mbiqëqyrje mbi zbatimin e dispozitave sipas neneve 40 paragrafi (2), 41, 51 dhe 58 paragrafi (1) të këtij ligji dhe akteve nënligjore të miratuara sipas neneve 74 paragrafi (2), 94 paragrafi (3) dhe 95 paragrafi (3) të këtij ligji kryen Ministria e Shëndetësisë.

(4) Mbiqëqyrje mbi zbatimin e dispozitave sipas nenit 41 dhe nenit 54 të këtij ligji kryen Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

**XII. DISPOZITAT PËR KUNDËRVAJTJE**

## Neni 101

(1) Gjohë në shumë prej 800 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik i cili nuk do të veprojë në përputhje me nenin 41, nenin 45, nenin 46, nenin 47, nenin 48, nenin 49, nenin 50, nenin 51, nenin 54 nenin 55 paragrafin (2) dhe (4), nenin 57 paragrafin (1), nenin 59 paragrafët (1), (3), (5) dhe (6), nenin 73 paragrafin (1), nenin 75, nenin 78 , nenin 79 dhe nenin 80 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

(2) Gjohë në shumë prej 100 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit udhëheqës në personin juridik.

(3) Gjohë në shumë prej 50 deri në 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni personit zyrtar.

## Neni 102

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 101 të këtij ligji, inspektori kompetent, para se të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes, është i detyruar që personit përgjegjës ose personit të autorizuar prej tij t'i ofrojë procedurë të barazimit me lëshimin e urdhërpagesës së kundërvajtjes, në përputhje me Ligjin për kundërvajtje.

(2) Kur kryerësi i kundërvajtjes pajtohet me procedurën e barazimit, inspektori përpilon procesverbal dhe i lëshon urdhërpagesë të kundërvajtjes personit përgjegjës ose personit të autorizuar prej tij.

(3) Procesverbalin dhe urdhërpagesën i nënshkruajnë inspektori dhe kryerësi i kundërvajtjes. Pas pranimit të urdhërpagesës së kundërvajtjes, kryerësi është i detyruar ta paguajë gjohën e shqiptuar në urdhërpagesën e kundërvajtjes, në afat prej tetë ditë nga dita e pranimit të urdhërpagesës së kundërvajtjes.

(4) Kur si kryerës i kundërvajtjes paraqitet personi juridik, procesverbalin dhe urdhërpagesën e kundërvajtjes e nënshkruan personi përgjegjës ose personi i autorizuar prej tij.

(5) Kryerësi i cili do ta paguajë gjohën në afatin sipas paragrafit (3) të këtij neni, do të paguajë vetëm gjysmën e gjohës së shqiptuar për të cilën të drejtë këshillohet në këshillën juridike.

(6) Nëse kryerësi nuk e paguan gjohën në afatin sipas paragrafit (3) të këtij neni, inspektori do të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes në organin kompetent.

(7) Në procedurën e barazimit, gjohë në urdhërpagesën e kundërvajtjes shqiptohet në shumën fikse të përcaktuar me ligj, ndërsa nëse gjoha është përcaktuar në shtrirje, shqiptohet shuma minimale e përcaktuar për kundërvajtje.

(8) Në procedurën e cila do të përfundojë me pagesën e urdhërpagesës së kundërvajtjes nuk paguhen shpenzimet e procedurës.

(9) Nëse kryerësi nuk pajtohet t'i lëshohet urdhërpagesë e kundërvajtjes, kjo do të shënohet në procesverbal për kundërvajtje të konstatuar, ndërsa inspektori parashtron kërkesë për ngritjen e procedurës së kundërvajtjes para gjykatës kompetente.

## Neni 103

Përcaktimi i lartësisë së gjohës për personat juridikë bëhet në përputhje me Ligjin e Kundërvajtjes.

## Neni 104

Për kundërvajtjet sipas nenit 101 të këtij ligji, procedurë të kundërvajtjes mban dhe sanksione të kundërvajtjes shqipton gjykata kompetente.

**XIII. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

## Neni 105

Trupi Bashkëndues Nacional sipas nenit 5 të këtij ligji do të formohet në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 106

Procedurat e filluara deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

## Neni 107

Ligjet që përmbajnë dispozita në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës ndaj femrave dhe dhunës në familje do të harmonizohen me këtë ligj, në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 108

Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

## Neni 109

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për parandalimin, ndërprerjen dhe mbrojtjen nga dhuna në familje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 138/14, 33/15 dhe 150/15).

## Neni 110

Në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, ndërpritet mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Trupit Bashkëndues Nacional për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

## Neni 111

Dispozitat sipas nenit 20, pika 2 dhe nenit 87, paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 112

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## МИНИСТЕРСТВО ЗА ПРАВДА

## 366.

Врз основа на член 18 став (1) точка в) и став (2) и член 19 од Законот за нотаријатот ("Службен весник на РМ" бр. 72/16, 142/16 и 233/18), Министерството за правда донесе

## РЕШЕНИЕ

## ЗА ПРЕСТАНОК НА ВРШЕЊЕ НА НОТАРСКАТА СЛУЖБА

1. На нотарот МАРИЈА ХАЦИ ПЕТРУШЕВА од Велес и престанува вршењето на нотарската служба по нејзино барање.
2. Решението влегува во сила на ден 29.01.2021 година.

## Образложение

Со решение бр. 08-4249/1 од 20.11.2001 година на министерот за правда Марија Хаџи Петрушева од Велес е именувана за нотар на подрачјето на Основниот суд во Велес.

Нотарот Марија Хаџи Петрушева од Велес до Министерството за правда достави Барање за престанок на вршење на нотарската служба заведено под бр. 09-123/1 од 13.01.2021 година, со кое бара да и престане вршењето на нотарската служба со 29.01.2021 година.

Според член 18 став (1) точка в) од Законот за нотаријатот, службата на нотарот престанува по негово барање, со истекот на рокот определен во барањето за престанок на службата. Според член 19 став (1) од Законот за нотаријатот, нотарот може во секое време да побара да му престане службата. Нотарот барањето го поднесува писмено до Министерството. Во барањето треба да биде определен рокот за престанок на вршење на службата.

Нотарот во барањето како рок за престанок на вршење на службата го определи датумот 29.01.2021 година.

Министерството за правда постапувајќи по поднесеното барање за престанување на вршење на службата на нотарот, имајќи ги во предвид одредбите од член 18 став (1) точка в) и став (2) и член 19 од Законот за нотаријатот, одлучи како во диспозитивот на ова решение.

ПРАВНА ПОУКА: Незадоволната страна има право да поведе управен спор во рок од 30 дена од денот на приемот на решението пред надлежниот суд.

Бр. 09-123/2

22 јануари 2021 година  
СкопјеМинистер за правда,  
м - р **Бојан Маричиќ**, с.р.

## 367.

Врз основа на член 71 став (1) точка в) и став (2) и член 72 од Законот за извршување ("Службен весник на Република Северна Македонија" бр.72/16, 142/16, 233/18 и 14/20), Министерството за правда донесе

## РЕШЕНИЕ

## ЗА ПРЕСТАНОК НА ДОЛЖНОСТА ИЗВРШИТЕЛ

На извршителот ВЕСНА МЛАДЕНОВИЌ од Скопје, именувана за подрачјето на Основниот кривичен суд Скопје и Основниот граѓански суд Скопје, и ПРЕСТАНУВА должноста извршител по нејзино барање.

Решението влегува во сила на 31.12.2020 година.

## Образложение

Со Решение на Министерот за правда бр.08-1740/1 од 09.05.2006 година лицето Весна Младеновиќ од Скопје е именувана за извршител за подрачјето на Основниот кривичен суд Скопје и Основниот граѓански суд Скопје.

Извршителот Весна Младеновиќ од Скопје на ден 16.11.2020 година поднесе барање до Министерството за правда заведено под УП1.бр.09-2763/1 од 16.11.2020 година, за престанок на должноста извршител, со кое бара да биде ослободена од вршење на должноста извршител, заклучно со 31.12.2020 година.

Согласно наведеното, а врз основа на член 71 став (1) точка в) и став (2) и член 72 од Законот за извршување, Министерството за правда одлучи како во диспозитивот на ова решение.

Правна поука: Против ова решение може да се поведе управен спор пред Управен суд во рок од 30 дена од денот на приемот на решението.

Бр. 09-2763/2

23 декември 2020 година  
СкопјеМинистер за правда,  
м - р **Бојан Маричиќ**, с.р.